



# RAPORTI VJETOR



**INTESA SANPAOLO BANK**

Albania



RAPORTI  
VJETOR  
'09

# PASQYRA E LËNDËS

<b>PERSHENDETJE E KRYETARIT</b>	<b>7</b>
<b>SITUATA MAKROEKONOMIKE NE VITIN 2009</b>	<b>10</b>
Parashikimet për vitin 2010	<b>14</b>
<b>EKONOMIA SHQIPTARE GJATE VITIT 2009</b>	<b>16</b>
Rritja ekonomike	<b>16</b>
Defiçiti tregtar dhe dërgesat	<b>17</b>
Punësimi dhe papunësia	<b>18</b>
Kursi i këmbimit	<b>18</b>
Inflacioni	<b>18</b>
Situata fiskale	<b>19</b>
Politikat Monetare	<b>20</b>
Sistemi Bankar	<b>20</b>
<b>NJE VESHTRIM MBI SITUATEN FINANCIARE</b>	<b>22</b>
Analiza e Drejtimit	<b>22</b>
Pritshmëria për të ardhmen	<b>26</b>
Marrëdhënia me klientët tanë	<b>27</b>
Marrëdhënia me punonjësit tanë	<b>28</b>
Marrëdhënia me shoqërinë	<b>29</b>
<b>RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR</b>	<b>31</b>
<b>INFORMACION BAZE</b>	<b>110</b>

# PERSHENDETJE E KRYETARIT

Gjatë vitit 2009 Intesa Sanpaolo Bank Albania demonstroi një ecuri të mirë pavarësisht nga situatata e vështirë globale makroekonomike e cila ndikoi negativisht në ekonominë Shqiptare.

Fitimi neto i Bankës u raportua Lek 1.6 miliard, i cili rezultoi nga rritja me 7% e totalit të aktivitetit, i cili në fund të muajit Dhjetor 2009 shënoi vlerën Lek 114.4 miliard.

Në të njejtën kohë, pavarësisht nga këto rrethana, Banka arriti me sukses të ruajë një pozicion të fortë likuiditeti i cili është fryt i besimit të fituar gjatë këtyre viteve.

Në përputhje me strategjinë afat gjatë Intesa Sanpaolo Bank Albania vazhdoi të përqëndrojë aktivitetin e saj në përmirësimin e cilësisë së produkteve të saj dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e klientëve.


Për arritjen e këtij objekti, gjatë vitit 2009 u bënë përpjekje të mëdha për edukimin e stafit të punonjësve, i cili konsiderohet një faktor kryesor për arritjen e cilësisë së lartë të synuar të shërbimeve që ofron banka.

Në Gusht 2009 Intesa Sanpaolo bleu nga Fondi Shqiptaro – Amerikan i Ndermarrjeve pjesën e mbetur të shoqërisë, e cila përfaqësonte 10% të kapitalit të saj: dhe si rezultat i kësaj blerje Intesa Sanpaolo tani zotëron 90,83% të totalit të aksioneve të Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Në marrëveshje me Filialet e tjera të Grupit Intesa Sanpaolo, Intesa Sanpaolo Bank Albania vazhdon të zhvillojë aktivitetet e veta sipas kuadrit të vlerave të Grupit, ku një rol të rëndësishëm kanë iniciativat e ndërmarrja nga Njësia për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë kolegët e mi të Këshillit Drejtues për bashkëpunimin e tyre të vlefshëm dhe të gjithë punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania për aktivitetin dhe angazhimin e tyre të përditshëm. Shpreh mirënjohje për të gjithë aksionerët për mbështetjen e Bankës dhe të gjithë klientët dhe partnerët tanë të biznesit për besnikërinë dhe besimin e tyre tek Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Massimo Pierdicchi  
Kyetar i Këshillit Drejtues









KAPITULLI



# SITUATA MAKROEKONOMIKE NË VITIN 2009 DHE PARASHIKIMI PËR VITIN 2010

Në vitin 2009, ekonomia botërore kaloi periudhën e recesionit më të keq që nga vitet '30. Niveli i rënies në aktivitetet e prodhimit në të gjitha ekonomitë kryesore të industrializuara, tensionet në tregjet kapitale dhe kërcënimi i një kolapsi në sistemin ndërkombëtar financiar nuk kanë precedencë në historinë e ekonomisë pas Luftës së Dytë Botërore. Rënia e investimeve, tkurrja e fluksit të tregtisë botërore dhe konsumi i vogël sollën rritjen e shpejtë të numrit të personave të papunë në të gjitha ekonomitë kryesore.

Pas stabilizimit gradual të sistemit financiar ndërkombëtar, vonë në pranverë u reflektuan shenjat e para të rikuperimit nga Azia dhe, më pas nga Shtetet e Bashkuara. Një rol kryesor kishin masat e forta të stimulimit fiskal të cilat u morën në kuadrin e përballimit të efekteve reale të krizës. Gjatë tremujorit të tretë, rikuperimi filloi të shtrihej në pjesën më të madhe të ekonomisë botërore, pasi bizneset filluan të rifitonin besimin, sidomos për te ardhmen.

Megjithatë, tendenca rritëse e treguesve të aktivitetit ekonomik nga faza e recesionit ishte modeste: në fund të vitit 2009, kapaciteti i madh i prodhimit që solli recesionin ishte ende i konsiderueshëm dhe norma e papunësisë vazhdoi të rritej në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara.

Sipas vlerësimeve më të fundit, tkurrja mesatare vjetore e PBB ishte -2.4 në Shtetet e Bashkuara dhe -4.0% në Eurozonë. Gjithsesi, falë rritjes së vendeve në zhvillim të Azisë, niveli i PBB në botë pësoi një rënie vetëm me 1%. Tkurrja e investimeve të qëndrueshme kapitale, në prodhimin industrial dhe veçanërisht në tregtinë e jashtme ishte 10% ose më e lartë se në Amerikën e Veriut dhe në Europë. Në veçanti prodhimi industrial në Eurozonë ra me 15.0% pas rënies së parë me 17% në vitin 2008 dhe niveli i eksporteve ra me 132% me çmimet konstante. Ndikimi i krizës në tregun e punës solli një rritje të normës së papunësisë nga 5.8% në 9.2% në Shtetet e Bashkuara dhe nga 7.6% në 9.4% në Eurozonë. Politikat fiskale dhe monetare vazhdojnë të mbeten gjithëpërfshirëse. Raporti i defiçitit ndaj/PPB u rrit mbi 9% në Shtetet e Bashkuara dhe mbi 6% në Europë. Rritja e shpejtë e borxhit publik u rregjistrua praktikisht në të gjitha ekonomitë e industrializuara. Në gjysmën e parë të vitit 2009, bankat qendrore i bënë më agresive masat e tyre të ekspansionit monetar, efektet e të cilave u shtrinë në gjysmën e dytë të vitit.

Në Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe në Japoni, autoritetet monetare inician

programet private për marrjen e borxhit në një përpjekje për të shtrënguar zgjerimin e ofertës monetare dhe influencimin direkt në kushtet e kreditimit në disa sektorë.

Në Eurozonë, ulja e normave zyrtare të ECB nga 2.5% në 1.0%, duke përfshirë dhe menaxhimin e jashtëzakonshëm të transaksioneve të tregut të lirë, duke financuar të gjitha kërkesat për fonde nga sistemi, pas paraqitjes së garancisë. Minimumi i përhershëm 1% u shoqërua me vendimin për të marrë pjesën e mbuluar me obligacione për shumën prej 60 miliard euro, me qëllim injektimin e mëtejshëm të parësë në sistem. Gjatë gjysmës së dytë të vitit ECB vazhdoi të zbatojë masa të jashtëzakonshme stimuluese duke mos sugjeruar se do të ndryshojë orientimin e politikës së tij monetare. Prandaj, norma për operacionet kryesore të rifinancimit mbeti në 1.0%. Blerjet e përhershme me mbulesë të obligacioneve vazhduan, dhe menaxhimi i jashtëzakonshëm i marrëveshjeve të riblerjes krijuan tepriçë të vazhdueshme likuiditeti në sistem. Në Dhjetor, Banka Qëndrore njoftoi se duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2010, do të shkurtonte në mënyre graduale masat sasiore të stimulimit, së pari duke reduktuar numrin e ankandëve të jashtëzakonshme për likuiditet dhe duke kufizuar gradualisht kriteret e pranuar për aplikimin e letrave me vlerë/securization për operacionet e kredisë në Eurosistem.

Likuiditeti i madh në sistem përshpejtoi rënien e normave të Euriborit, të cilat arritën nivelin më të ulët të të gjitha kohërave. Norma mujore ra në 0.42%, 215 pikë bazë nën nivelin e raportuar në fund të vitit 2008, ndërsa niveli tremujor i Euriborit ishte më i ulët se norma e rifinancimit që nga muaji Korrik. Lidhur me faturimin më shumë se një vit, rënia në periudhën nga Janari në Maj u shoqërua me një tendencë jo të barabartë, me ngritje ulje të mëdha. Në vitin 2009 shkëmbimi i normës 2 vjeçare të interesit u mbyll me 1.85%, 81 pikë bazë më i ulët se nivelet në fillim të vitit; IRS për periudhën 10 vjeçare u mbyll me 3.59%, vetëm 12 pikë bazë nën nivelin e vitit të mëparshëm dhe pak mbi vlerën e nivelit të ndryshueshëm prej 3.24-3.85%.

Përkeqësimi i kuadrit fiskal solli rritjen e paqëndrueshmërisë së spredit shtetëror, me zhvillime të përkohshme reperkusioni në spredin BTP-Bund në muajin Janar dhe në periudhën në mes të muajit Shkurt dhe Mars. Tensionet më të forta u ndjenë në fillim të vitit për borxhin publik të Irlandës dhe Austrisë; në fund të vitit njoftimi për rishikimin emergjent të deficitit dhe borxhit publik të Greqisë sollën një përkeqësim të borxhit shtetëror të vendit nga agjencitë e klasifikimit dhe shënuan rritjen e spredit në krahasim me të gjithë emetuesit në Eurozonë. Pavarësisht nga efektet e krizës në Greqi, spredi Btp-Bundë e mbylli vitin me një rënie nga 135 pikë bazë në fillim të Janarit në 74 pikë bazë në fund të vitit. Asnjë vend evropian nuk kishte vështirësi për mbulimin e ankandëve të obligacioneve të thesarit, pavarësisht shqetësimeve për stabilitetin fiskal.

Tregjet valutore shënuan lëvizje të rëndësishme. Kursi i këmbimit Euro/Dollari Amerikan, i cili në tre muajorin e parë shënoi një nivel të ulët 1.26, rrjedhimisht shfaqti një tendencë rritëse në 1.51; në Dhjetor, kursi i këmbimit u stabilizua në nivelet 1.42 në 1.45. Ecuria e Euros kundrejt paund-it, yen-it dhe monedhave që përfitojnë nga tregtia si dollari Australian ka qenë e ndryshueshme.

Lidhur me ecurinë e bursës, pas një fillimi negativ në fillim të vitit, për shkak të thellimit të krizës financiare dhe ngadalësimit të madh të ekonomisë globale, ku një numër i madh sektorësh kaluan në të njëjtën kohë në recesion, tregjet ndërkombëtare të bursës hynë në fazën e rikuperimit të fortë dhe të qëndrueshëm nga nivelet e ulta që kaluan në gjysmën e parë të muajit Mars 2009.

Kjo kthesë e dukshme u nxit dhe iniciua në mënyre të veçantë nga masat e shumta dhe stimujt fiskal që zbatuan qeveritë dhe bankat qëndrore, si dhe nga shenjat e para të stabilizimit të ekonomisë botërore; rënia graduale e riskut më pas favorizoi kthimin e investitorëve në bursë.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit, tendenca pozitive u mbështet më tej nga raportet tremujore të kompanive, të cilat në shumicën e rasteve pasqyronin stabilizimin e marzheve, të cilat u arritën nëpërmjet politikave strikte të kontrollit të shpenzimeve dhe diversifikimit gjeografik drejt sektorëve që tregonin ecuri më të mirë ekonomike. Disponueshmëria e vazhdueshme e likuiditetit përbente gjithashtu një mbështetje për investimet në bursë.

Gjatë vitit 2009, indeksi F&Sh u rrit me 23.5%. Të njëjtën ecuri patën dhe treguesit e tregjeve kryesore Europiane të bursës: DAX u rrit me 23.8%, dhe CAC 40 me 21.2%; FTSE 100 e mbylli vitin me një rritje prej 22.1 %. Së fundmi, DJ Euro Stoxx rifitoi 24.4% nga Janari, pasi shënoi piken më të ulët prej -24% në 9 Mars. Bursat aziatike shënuan një rritje të konsiderueshme në vitin 2009: Indeksi i Kompozicionit SSE të tregut Kinez e mbylli vitin me 79.8%, dhe Nikkei u rrit me 19%.

Në lidhje me obligacionet e korporatave, viti 2009 dëshmoi një zvogëlim të dukshëm dhe të përgjithshëm të spredeve në të gjithë segmentet e tregut. Rikuperimi i dukshëm, i cili ndryshoi tendencën negative që mbizotëroi gjatë dy muajve të parë të vitit, i atribuohet kryesisht zbutjes së frikës së krizës së sistemit ndërkombëtar financiar, e cila kishte sjelle rritjen e madhe të rrezikut dhe kishte nxitur rishpërndarjen e kujdesshme të portofolit, i cili kishte penalizuar produktet e spredit. Rikuperimi i tregjeve të kredisë u arrit edhe në saj të reagimit të fortë të tregjeve ndërkombëtare kryesore të bursës duke filluar që në fillim të muajit Mars, e cila u shoqërua nga një reduktim i konsiderueshëm i luhatshmërisë. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, lajmet nga fusha makroekonomike konfirmuan stabilizimin e ciklit, duke inkurajuar shpresat për një rikuperim të fortë në vitin 2010. Kthimi gradual i tregjeve financiare në normalitet dhe sinjalet pozitive nga fusha makroekonomike sollën ecurinë e mirë pozitive të segmentit të parasë. Në segmentin e investimit Investment Grade, ecuria më e mirë u regjistrua nga letrat me vlerë jo financiare dhe huatë BBB. Ky segment u karakterizua nga nivelimi i kurbave të klasifikimit të kredisë, siç u pasqyrua për shembull në vjeshtë me afërsisht 200 pikë bazë të diferencimit BBB-AAA. Pas trazirave të fundit, vëmendje e madhe vazhdon ti kushtohet të dhënave për ecurinë aktuale dhe në të ardhmen të ciklit ekonomik dhe strategjive të daljes nga masat e jashtëzakonshme fiskale dhe stimujt monetarë të zbatuara deri me sot në përgjigje të recesionit.

Viti 2009 dëshmoi një ngadalësim në ciklin ekonomik të tregjeve të reja; gjithsesi norma e rritjes së ekonomisë në përgjithësi mbeti në nivele pozitive. Sipas të dhënave paraprake, rritja e PBB ishte disi më pak se 2%, krahasuar me +6% në 2008 dhe +8% në 2007.

Norma e ngadalësimit u shpërnda në mënyre të pabarabartë në sektorë të ndryshëm. Vendet në zhvillim të Azisë regjistruan një rënie mesatare, në një kohe ku rritja e PBB ishte ende mbi 6%. Politikat monetare dhe fiskale që miratuan qeveritë e vendeve kryesore kanë kompensuar pjesërisht kontributin e ulët nga tregtia e jashtme. Kina dhe India drejtuan ekonominë aziatike, me dinamika produkti të cilat janë vlerësuar respektivisht afërsisht me 8% dhe 6%. Vendet e industrializuara së fundmi - Koreja, Hong Kong, Singapori dhe Taiëani – vërtetuan se ishin më të ndjeshëm për shkak të tregtisë së jashtme dhe marrëdhënieve financiare, dhe përjetuan një rënie më të madhe në aktivitetin ekonomik gjatë vitit.

Në sajë të marrëdhënieve tregtare me Shtetet e Bashkuara dhe Evropën, së bashku me ekspozimin e madh ndaj ciklit të produkteve, Amerika latine hyri në recesion, me një rënie ekonomike prej 2%. Recesioni ishte mjaft i ashpër për Meksikën, ku sektori i prodhimit varet kryesisht nga cikli i Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, bazat e forta dhe menaxhimi efikas i politikave ekonomike, bënë të mundur që vendet e Amerikës Latine, në veçanti Brazili, Kili, Kolumbia dhe Peruja, të kalojnë krizën aktuale më mirë se të gjitha situatat e tjera kritike në të kaluarën. Nga ana tjetër, një përgjigje qeveritare më pak efektive ndaj krizës dhe varësia nga cikli i produkteve dhe mallrave bëri që Argjentina dhe Venezuela të jenë më të dobëta dhe prekshme nga kriza; në këto vende PBB ra afërsisht me 3%.

Rritja e GDP u ngadalësua shumë në vendet e Lindjes së Mesme, ndërkohë që niveli i përgjithshëm ishte pozitiv me +2% në 2009 nga +5.4% në 2008. Ekonomitë e vendeve të Gjirit Persik u prekën nga rënia e të ardhurave nga nafta dhe nga vështirësitë që po kalonin sektori financiar dhe sektori i pronave të patundshme, duke sjellë kështu tkurrjen e rritjes së PBB, madje dhe rënien e tij. Vendet e Afrikës së veriut si Egjipti, Jordania, Maroku dhe Tunizia, të cilat kanë ekonomi të diversifikuara, shënuan një ngadalësim të ciklit të tyre ekonomik, duke iu shmangur recesionit. Nivelet e qëndrueshëm të kërkesës së brendshme, me mbështetjen e politikave stimuluese, zvogëluan ndikimin e goditjeve të jashtme. Në veçanti, Egjipti, viti fiskal i të cilit përfundoi në Qershorin e kaluar, shënoi një rritje të PBB me afërsisht 5%.

Defiçiti i konsiderueshëm i llogarisë korrente, varësia e madhe nga sektori privat nga financimi i huaj dhe defiçiti i madh publik, i cili la pak hapësirë veprimi për masat e brendshme stimuluese, lidhjet e forta tregtare me vendet e Evropës perëndimore të cilat vetë ishin në recesion, dhe së fundmi për vendet SHPC (Shtetet e Pavarura të Commonëalth), ekspozimi i madh ndaj ciklit të mallrave dhe produkteve, çoi PPB të vendeve të Evropës Lindore në recesion (vendet Balltike, EQL, SHPC dhe EKL). Disa vende, përkatësisht vendet Balltike dhe Ukral regjistruan një rënie me dy shifra të PBB. Rusia dhe disa vende të EQL (Hungaria) dhe EKL (Bullgaria dhe Rumania) shënuan një rënie të nivelit të PBB nga 6 dhe 9%.

Në vendet në zhvillim autoritetet e politikave ekonomike miratuan në përgjithësi masa të rrepta të stimulimit ekonomik. Normat e interesit ishin në nivelet më të ulta të të gjitha periudhave. Shumat e mëdha të likuiditetit u injektuan në sistemet financiare, dhe shpenzimet publike, me përjashtim të vendeve të Evropës Lindore, u rritën ndjeshëm në mbështetje të kërkesës. Këto masa, së bashku me mbështetjen financiare të institucioneve ndërkombëtare që iu dha vendeve të cilat po përballeshin me kriza të mundshme likuiditeti lehtësuan së pari stabilizimin e mjedisit ndërkombëtar financiar dhe për rrjedhojë rikuperimin e ekonomisë së vërtetë.

Në kuadrin e kësaj situatë, tregjet kapitale, pas një tremujori të parë ende të vështirë, regjistruan rritje të mëdha dhe në masë. Gjatë vitit 2009 indeksi MSCI (Morgan Stanley Capital International) për tregjet e bursës së vendeve në zhvillim shënuan një rritje afërsisht 60%, krahasuar me rritjen prej 20% të tregjeve të bursës të Eurozonës, Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara. Në botë, progresin më të mirë e shënoi Brazili, Rusia, India dhe Kina (BRICs), pasi perspektivat e rritjes tejkaluan parashikimet, së bashku me Turqinë (+96%) dhe Hungarinë (+73%). Në fund të klasifikimit mbeten disa nga vendet e Evropës Lindore (indekset e bursës së Sllovenisë dhe Kroacisë u rritën përkatësisht me 10% dhe 16%, ndërsa indeksi Sllovakisë ra me 25%) të cilat u preken nga recensionin dhe frika e konkurrencës, si dhe disa vende të Gjirit Persik të cilat janë rënduar nga rënia e sektorëve financiar dhe të pronave të patundshme.

Gjatë vitit 2009, spredi CDS për borxhin shtetëror u ul ndjeshëm; pas kulmit që arriti në shumë raste gjatë tremujorit të katërt dhe në fund të vitit pjesa më e madhe e tyre ishte rikuperuar në nivelet e Shtatorit 2008, përpara fillimit të krizës financiare. Indeksi OITP (Partnere të Tjerë të Rëndësishëm Tregtar) për vlerat e këmbimeve valutore të Dollarit Amerikan kundrejt monedhave të vendeve në zhvillim – të cilat janë partnerë të rëndësishëm tregtar të Shteteve të Bashkuara – ra më 3.6% në 2009. Kjo tendencë pasqyron rritjen e konsiderueshme të USD ndaj monedhës së Amerikës Latine (monedha e Brazilit dhe Kilit u rrit më shumë se 20%, falë prurjeve të mëdha të kapitalit), Azisë (Indonezia +14.5%, Koreja + 7.5%) dhe Evropës Lindore (Bullgaria, Kroacia, Polonia dhe Republika Çeke, e cila u rrit midis 3% dhe 4%), stabiliteti i përgjithshëm i monedhave të vendeve të Gjirit Persik dhe Kinës, dhe rënia e disa monedhave të vendeve të SHPC (Rusia -3%, Ukraina më shumë se -4%). Humbja e regjistruar ndaj dollarit nga disa monedha të Evropës Lindore (krahas Rusisë dhe Ukrainës, edhe Rumania dhe Hungaria) fillimisht ishte rezultat i nivelit të lartë të borxhit të jashtëm. Pas arritjes së nivelit të ulët në fund të muajit Shkurt, këto monedha filluan të rifitonin humbjet e tyre (por në mbyllje të vitit u zhvlerësuan sërisht kundrejt dollarit dhe Euros), si rrjedhojë e

planeve të stabilizimit, ndihmës financiare nga institucionet ndërkombëtare (që ju dha ndër të vendeve të tjera Bosnjës, Lituaniës, Serbisë, Rumanisë, Hungarisë dhe Ukrainës) dhe për Rusinë, nga rikuperimi i çmimit të naftës. Gjatë vitit agjencitë e klasifikimit raportuan një rritje të besimit tek ekonomitë në zhvillim. Niveli i rritjes, më i madh në Amerikën Latine (Bolivi, Kili, Ekuador dhe Peru) dhe në Azi (Indonezi dhe Filipinet tejkaloi nivelin e rënies, që kaluan vendet balltike, disa vende të SHPC (Kazakistan, Ukraina dhe Meksika).

## PARASHIKIMET PËR VITIN 2010

Viti 2010 pritet të jetë një vit i rikuperimit ekonomik, i cili do të mbështet nga qëndrimet dhe politikat ekspansioniste fiskale dhe monetare, por do të shoqërohet me një papunësi në rritje, kapacitet të madh të vazhdueshëm prodhimi dhe trysni mbizotëruese deflacioni. Prodhimi i brendshëm bruto do të tregojë një rritje relativisht të madhe vetëm në vendet Europiane në zhvillim, eksportuesit e mallrave dhe Shtetet e Bashkuara. Në Eurozone, rikuperimi, më pak mbështetje nga stimuj fiskal dhe kërkesë të madhe të brendshme, do të jetë i ngadalte dhe shumë i ndryshëm.

Stabiliteti më i madh i tregjeve financiare do të bëjë të mundur që bankat qëndrore të tërhiqen nga masat e shumta monetare jo të zakonshme të miratuara midis viteve 2008 dhe 2009. Megjithatë, tërheqja e rezervave të tepërta do të jete graduale dhe do të përfshijë rritje të vogla të normave të interesit për periudha maturimi të shkurtra. Të gjitha rritjet e normave benchmark do të jenë të vogla. Skenari i likuiditetit të bollshëm, rritjes së ngadalte dhe inflacionit të ulët duhet të favorizojë stabilitetin e normave për periudhat afat-mesme dhe afat-gjata të maturimit.

Lidhur me normat e tregut të parasë, normat bankare pritet të rriten pak gjatë vitit.

Skenari i kredihënies do të influencohet nga përmirësimi i ciklit ekonomik, i cili gjithsesi do të vazhdojë të influencohet nga rritja e ngadalte e ekonomisë, norma e madhe e papunësisë dhe rreziku i lartë i kredisë.

Ndryshimet strukturore që lidhen me rishikimin e kuadrit rregullator financiar do të jenë të rëndësishme. Ndryshimet e mundshme të rregulloreve për kapitalin e bankës dhe kërkesat për likuiditet e bëjnë situatën në veçanti të pasigurtë.

Megjithatë, aktiviteti i kredihënies pritet të rikuperohet në mënyrë graduale gjatë vitit 2010 në një linjë me përmirësimin gradual të ciklit ekonomik. Megjithatë, për shkak të vonesës tradicionale në emergjencën e kredive me probleme, e cila është përkeqësuar si rezultat i vështirësive të vazhdueshme të parashikuara me të cilat u përballen biznese në një skenar të rritjes së ulët, rregullimet e kredive do të vazhdojnë të kenë një impakt dhe ndikim të madh në fitimet e bankës.

Financimi direkt do të vazhdojë të jetë një stimul strategjik, megjithëse pritet që të ngadalësohet gjatë vitit 2010, paralelisht me kthimin gradual në normalitet të parasë dhe tregjeve financiare, e cila do të inkurajojë investitorët për të kaluar në instrumenta me rrezik më të lartë kthimi për rrjedhojë tendenca në përmirësim e aktiveve nën drejtimin e vitit 2009, pritet të vazhdojë.



KAPITULLI



# EKONOMIA SHQIPTARE GJATË VITIT 2009

## RRITJA EKONOMIKE

Ekonomia shqiptare i ngadalësoi ritmet e rritjes gjatë vitit 2009, duke reflektuar pasojat e krizës ekonomike globale, që arritën kulmin gjatë vitit të kaluar. Sipas të dhënave të INSTAT, rritja vjetore e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2009 vlerësohet paraprakisht të ketë qenë 3.3%, një nivel rritjeje që është pranuar dhe nga institucionet ndërkombëtare, nga rreth 7.8% që u vlerësua ky tregues në 2008-n. Shqipëria rezultoi ndërkohë ndër të paktat shtete në Evropë që shënuan rritje ekonomike pozitive gjatë 2009-s.

Shpenzimet e larta buxhetore, sidomos në pjesën e parë të vitit, në prag të zgjedhjeve elektorale që u mbajtën në qershor 2009, ishin një stimul i rëndësishëm që ndikuan në ritmet e larta të rritjes në dy tremujorët e parë të vitit (përkatësisht 3.8% me bazë vjetore në T I 2009 dhe 6.3% në T II). Më pas ritmet e rritjes u ngadalësuan, duke zbritur në 3.9% me bazë vjetore në tremujorin tretë dhe për herë të parë ekonomia shënoi ritme rritjeje negative në tremujorin e fundit, me -0.8%.

Postë telekomunikacioni është sektori që ka shënuar rritjen më të madhe vjetore gjatë vitit 2009 prej 28.2%, i nxitur nga shtimi i konkurrencës së operatorëve celularë. Ndërtimi shënoi një ecuri pozitive gjatë pjesës së parë të vitit (me rritje vjetore prej 3.9 dhe 18.2% përkatësisht në tremujorin e parë dhe të dytë), por i stimuluar kryesisht nga shpenzimet e larta kapitale, në pjesën më të madhe të adresuara për rrugën Durrës-Kukës, që morën 38 miliardë lekë (rreth 3.5% të PBB-së). Gjysma e dytë e vitit nxori në pah problemet reale të ndërtimit, me ngadalësim të rritjes së shifrës së afarizmit, të vëllimit të ndërtimit dhe të konsumit të dukshëm të çimentos si dhe shtim të problemeve të likuiditetit tek ndërtuesit, i ndikuar dhe nga frenimi i menjëhershëm i huasë bankare për këtë sektor. Ndërtimi rezultoi me një rritje totale me bazë vjetore për 2009-n prej vetëm 0.6%.

Industria ishte sektori me performancën më negative gjatë 2009-s, duke shënuar një rënie me bazë vjetore prej -1.2%, me eksportet që u goditën nga rënia e kërkesës në tregjet ndërkombëtare. Investimet private kanë reflektuar goditjen kryesore të krizës botërore financiare dhe ekonomike, duke rënë në 21.6% të PBB-së në vitin 2009, nga 23.9% të PBB-së në 2008-n. Edhe kërkesa konsumatore u reduktua në tremujorin e tretë, duke treguar një frenim të konsumit të brendshëm, që erdhi kryesisht si rrjedhojë e reduktimit të prurjeve të emigrantëve, rënies së kredisë për individë dhe nënçmimit të kursit të këmbimit.

Bujqësia, tregtia e hotelet dhe transporti shënuan një ecuri relativisht pozitive me një rritje vjetore përkatësisht 2.7%, 5.4% dhe 8.3%, që janë gjithsesi më të ulëta në krahasim me vitin paraardhës.

Për vitin 2010, qeveria parashikon një nivel të kënaqshëm të rritjes ekonomike në 4-5%, ndërsa institucionet ndërkombëtare presin që vendi të vijojë të ketë ritme të ulëta rritjeje



prej 2-3%, duke reflektuar edhe në një të ardhme afatmesme pasojat e krizës ekonomike globale.

## DEFICITI TREGTAR DHE DËRGESAT

Efektet e krizës globale u reflektuan në një ngadalësim të aktivitetit tregtar gjatë vitit 2009, si në kahun e eksporteve ashtu dhe të importeve.

Eksportet shënuan një rënie prej 18% me bazë vjetore, sipas të dhënave nga Bilanci i Pagesave i Bankës së Shqipërisë. Grupmali “materiale ndërtimi dhe metale” dha kontributin kryesor në këtë rënie, teksa eksportet e tyre u përgjysmuan. Tekstilet e këpucët, që përbënin 47% të totalit të eksporteve gjatë 2009-s shënuan një rënie të lehtë prej 1.3%.

Importet shënuan një rënie me bazë vjetore prej rreth 9%, me importet e mineraleve, lëndëve djegëse dhe energjisë që dhanë kontributin kryesor në këtë rënie. Raporti i mbulimit të importeve me eksporte zbriti në 24.5% nga 27.4% në 2008-n.

Tkurrrja e aktivitetit tregtar nuk arriti të reduktonte ndjeshëm deficitin e llogarisë korente, siç ndodhi në vendet e tjera të rajonit. Ky tregues ra lehtë nga 15.8% e PBB-së në 2008-n në 15.6% të PBB-së në 2009-n, nivel që konsiderohet i lartë dhe i paqëndrueshëm.

Fluksi i lartë i transferimit të fitimit nga kompanitë ndërkombëtare që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri ishte arsyeja kryesore që ndikoi negativisht në deficitin e llogarisë korente gjatë vitit të kaluar.

Bilanci neto u të ardhurave nga turizmi rezultoi për të dytin vit rresht pozitiv, por gjithsesi ai mbetet mjaft i ulët për të dhënë ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e deficitit të llogarisë korente.

Të ardhurat e emigrantëve, vijuan tendencën e tyre në ulje edhe gjatë vitit 2009, duke reflektuar si prirjen rënëse ciklike, ashtu dhe pasojat e krizës në vendet ku emigrantët punojnë e jetojnë. Transfertat e emigrantëve u reduktuan me 6% me bazë vjetore në 2009-n, në një kohë që një vit më parë reduktimi vjetor kishte qenë 12.5%. Roli i transfertave të emigrantëve në financimin e deficitit të llogarisë korente sa vjen e po zvogëlohet. Deri në vitin 2007, këto transferta financonin krejtësisht deficitin e llogarisë korente, ndërsa gjatë dy viteve të fundit ato kanë arritur ta mbulojnë pjesërisht atë, sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë.

Rritja e eksporteve me vlerë të lartë të shtuar, tërheqja e investimeve të huaja direkte, rritja e flukseve pozitive të të ardhurave nga turizmi shihen si burimet kryesore të thithjes së valutës së huaj në të ardhmen.

### ECURIA E BILANCIT TË LLOGARISË KORENTE SIPAS ZËRAVE

	2005	2006	2007	2008	2009
Llogaria korente (mln euro)	589	-471	-831	-1,370	-1,327
Llogaria korente (% ndaj PBB)	-7.3	-7.3	-11.4	-15.8	-15.6
Importet (mln euro)	-1,477	-1,659	-2,104	-2,431	-2,304
Eksportet (mln euro)	530	631	786	917	751
Bilanci tregtar (mln euro)	-1,477	-1,659	-2,104	-2,431	-2,304
Bilanci tregtar (% ndaj PBB-së)	-22.3	-22.6	-26.8	-27.4	-26.6
Bilanci neto i shërbimeve mln euro	-140	-32	13	69	121
(kryesisht hyrjet dhe daljet nga turizmi)					
Bilanci neto i të ardhurave- mln euro-	131	209	217	55	-79
(të ardhurat nga puna hyrëse; daljet nga transferimi fitimit)					
Transfera korente -mln euro-	897	1,011	1,043	937	934
(kryesisht prurjet nga emigrantët)					

Burimi: Banka e Shqipërisë

## PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA

Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik gjatë 2009-s u dha efekt dhe në treguesit e punësimit. Të dhënat e publikuara nga INSTAT flasin për një rënie të lehtë me rreth 2140 vetë të të punësuarve në sektorin privat jo bujqësor në krahasim me fundin e 2008-s. Tkurria e aktivitetit industrial u pasqyrua në një rënie mesatare vjetore të të punësuarve në këtë sektor me rreth 4.1 për qind në tre tremujorët e parë të vitit, sipas Bankës së Shqipërisë.

Norma e papunësisë rezultoi 13.75% në fund të tremujorit të katërt 2009, nga 12.68% në fund të 2008-s. Rritja e menjëhershme në normën e papunësisë i dedikohet rishikimit të numrit të të vetëpunësuarve në sektorin privat bujqësor në tremujorin e katërt 2009 (i cili u rivlerësua në bazë të Anketës së Forcës së Punës 2008), çka çoi në uljen e të punësuarve në këtë sektor me rreth 72,360 vetë. Njëkohësisht u ul me rreth 70 mijë vetë edhe forca e punës gjithsej. Vlerësimi i saktë i niveli të papunësisë vijon të mbetet i vështirë për shkak të raportimeve jo shumë të besueshme dhe ndryshimeve të herëpashershme me tendencë ulëse në numrin e forcave aktive për punë, që synojnë ruajtjen e niveleve të ulëta të papunësisë.

## KURSI I KËMBIMIT

Pas katër vjet stabiliteti, monedha shqiptare shfaqti prirje të forta nënçmuese gjatë vitit 2009. Leku u zhvlerësua vazhdimisht ndaj euros, sidomos në pjesën e dytë të vitit. Kursi mesatar i lekut kundrejt euros rezultoi 132.06 lekë për një euro, duke u nënçmuar 7.5% në krahasim me kursin mesatar përkatës të 2008-s. Edhe dollari u kuotua mesatarisht në 95 lekë për një dollar, me një rritje prej 13.5% në krahasim me mesataren e 2008-s. Lulahshmëria e raporteve euro/lek dhe dollar/lek gjatë vitit 2009 ka rezultuar e lartë, duke reflektuar kështu raportin e lëkundur të ofertës me kërkesën si dhe pasigurinë e agjentëve të tregut, sipas konstatimeve nga banka e Shqipërisë. Stimuli i lartë monetar në monedhën vendase nga Banka e Shqipërisë, që furnizoi vazhdimisht bankat me likuiditete, në kahun e ofertës për lekë dhe transferimi i fitimeve nga kompanitë ndërkombëtare, në kahun e kërkesës për valutë, ishin faktorët kryesorë që ndikuan në sjelljen nënçmuese të lekut, të shoqëruara dhe nga një lëkundje e besimit të publikut ndaj sistemit financiar dhe e instrumenteve të ofruar prej tij.

Zhvlerësimi i lekut nxori në pah rrezikun e kredisë së marrë në valutë për të gjithë ata që kanë të ardhura në lekë, ndërsa i bëri bizneset më të kujdesshme në menaxhimin e pozicioneve të tyre valutore.

## INFLACIONI

Pas niveleve të larta në vitin 2008, inflacioni qëndroi në nivele të ulëta gjatë 2009-s, megjithatë shfaqti prirje me kah rritës gjatë dy tremujorëve të fundit. Norma e inflacionit vjetore në fund të dhjetorit rezultoi 2.5%, duke qenë pak mbi kufirin minimal prej 2% të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

Sipas Bankës së Shqipërisë "Analiza e komponentëve përbërës evidenton ndikimin kryesor që ka dhënë kategoria "Ushqime të papërpunuara" në nivelin e përgjithshëm të inflacionit. Inflacioni i kësaj kategorie, në disa raste ka shënuar norma rritjeje të larta, duke formuar në masën 82 për qind inflacionin total në terma mesatarë". Inflacioni vjetor i kategorisë "Ushqime të papërpunuara" ka shënuar një normë mesatare rritjeje prej 9.9 për qind gjatë vitit 2009. Pësha e lartë që zënë ushqimet në shportën e mallrave mbi bazën e të cilave llogaritet Indeksi i Çmimeve të Konsumit (37.2% të totalit), e bën inflacionin mjaft të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të çmimeve të ushqimeve.

Nënçmimi i lekut ndaj valutave ka qenë një tjetër faktor që ka ndikuar në tendencën inflacioniste gjatë 2009-s, i shoqëruar dhe nga një prani të prirjes rritëse të çmimeve të lëndëve

të para në tregjet botërore. Në kushtet kur një pjesë e madhe e produkteve bujqësore vijnë nga importi (në pamundësi të prodhimit vendas për të plotësuar kërkesën për këto mallra), çmimet e importuara mbeten tepër të varura nga ecuria e kursit të këmbimit, duke bërë të pandjeshëm faktin që nivelet e çmimeve të huaja ishin relativisht të ulëta gjatë 2009-s. Një strategji e zëvendësimit të importeve me prodhim vendas për ata sektorë ku kemi përparësi krahasuese do të ulte varësinë e çmimeve ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

## SITUATA FISKALE

Gjatë vitit 2009 qeveria ndoqi një politikë fiskale zgjeruese në drejtim të kryerjes së shpenzimeve, në një kohë që të hyrat në buxhet shënuan një rritje minimale në pothuajse të gjitha zërat tatimore, duke reflektuar ngadalësimin e ekonomisë vendase.

Shpenzimet qeveritare janë rritur me 13% në nivel vjetor gjatë vitit 2009, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, duke arritur në 33.2% të PBB-së. Ritmi i rritjes së shpenzimeve ishte veçanërisht i lartë gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2009, që përkoi me periudhën paraelektorale për t'u zvogëluar më pas gjatë pjesës së dytë të vitit, ku u konstatua një tërheqje e stimulit fiskal. Edhe gjatë vitit 2009 vijoi përqendrimi i madh i shpenzimeve kapitale në projektin madhor të rrugës Durrës-Kukës, të cilat përbënin 40% të totalit të shpenzimeve kapitale gjatë atij viti. Të ardhurat buxhetore shënuan një rritje nominale minimale prej 2.7% (duke arritur në 26.2% të PBB-së), ndërsa rritja reale e të ardhurave konsiderohet negative, duke pasur parasysh që ekonomia u rrit me 3.3% në të njëjtën periudhë dhe inflacioni në fund të viti rezultoi 2.5%. Shtimi i shpenzimeve me ritme më të larta se e të ardhurave çoi në një rritje të deficitit buxhetor, i cili arriti në rreth 7% të PBB-së në fund të vitit. Burimet kryesore të financimit të deficitit ishin të ardhurat nga privatizimet (të cilat kanë financuar rreth 35% të deficitit buxhetor), kredia sindikale (që mbuloi 31% të tij) dhe huamarrja e brendshme me letra me vlerë (23%).

Stoku i borxhit arriti në një nivel rekord prej rreth 60% të PBB-së, duke arritur kufirin maksimal të vendosur me ligj (Rreth 61 për qind e stokut të borxhit publik përfaqësohet nga borxhi i brendshëm, dhe pjesa e mbetur i takon stokut të borxhit të jashtëm). Qeveria shtyu planin për emetimin e eurobondeve për në vitin 2010, si rrjedhojë e situatës së pafavorshme në tregun ndërkombëtar, të krijuar nga kriza globale financiare e ekonomike.

Në kushtet kur ndjeshmëria e tregjeve ndërkombëtare ndaj borxheve kombëtare është rritur ndjeshëm, si rrjedhojë e krizës në Greqi, një sjellje e kujdesshme fiskale në të ardhmen, e shoqëruar me ulje të deficitit buxhetor e reduktim të borxhit publik do të ishte e domosdoshme, në mënyrë që të rritet besueshmëria e vendit dhe të mundësohet emetimi i eurobondeve me kosto sa më të ulët.

### TË DHËNA KRYESORE MAKROEKONOMIKE 2005-2009

	2005	2006	2007	2008	2009
Inflacioni vjetor (%) fund v/v	2.0	2.5	3.1	2.2	3.5
Norma e papunësië (%)	14.2	13.8	13.2	12.7	13.8
Norma reale e rritjes së PBB (%)	5.7	5.4	6.2	7.8*	3.3*
PBB me çmimet aktuale (milion lek)	814,797	882,209	966,651	1,087,867*	1,143,373*
PBB për frymë (USD)	2,597	2,854	3,394	4,073*	3,765*
Borxhi publik (% të PBB-së)	57.4	56.1	53.5	54.8	59.5
Deficiti i buxhetit (% të PBB-së)	-3.5	-3.3	-3.5	-5.5	-7
Kursi mesatar i këmbimit (lek për 1 eur)	124.2	123.1	123.6	122.8	132.1
Kursi mesatar i këmbimit (lek për 1 USD)	99.9	98.1	90.4	83.9	95.0

Burimi: Ministria e Financave, BSH, INSTAT,  
\*vlerësim

## POLITIKA MONETARE

Banka e Shqipërisë ka qenë mjaft aktive gjatë viti të kaluar, duke luajtur një rol të rëndësishëm në qetësimin e tregut bankar, pas pasigurisë që shoqëroi zhvillimet në treg që nga tremujori i fundit i vitit 2008. Sistemi bankar është furnizuar me likuiditet të bollshëm, të vazhdueshëm dhe me kosto në rënie nga Banka e Shqipërisë, duke neutralizuar mungesën e likuiditetit të bankave si rrjedhojë e tkurrjes së nivelit të depozitave. Banka Qendrore ka bërë të ditur se ka ndërhyrë në treg me anë të operacioneve në treg të hapur, apo në mënyrë verbale, për të ulur tensionet në treg, për të nxitur tregtimin dhe për të siguruar agjentët ekonomikë e financiarë mbi ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë monetare lehtësuese, me synim nxitjen e kredisë, ritmet e të cilës u ngadalësuan ndjeshëm gjatë 2009-s. Banka Qendrore mori vendim për uljen e normës bazë të interesit në dy raste, në muajt janar dhe tetor 2009, duke e zbritur atë në nivelin 5.25% nga 6.25% që ishte në fund të vitit 2008. Vendimet u reflektuan në treg me një periudhë disa mujore vonesë, teksa kërkesa e lartë e qeverisë për financim të brendshëm mbajti të lartë yield-in e bonove të thesarit (që përdoret si referencë për çmimin e kredisë në lekë), të cilat shënuan tendencë rritëse deri në tetor dhe vetëm pas këtij muaji u vu re reagimi në rënie.

Zhvillimet afatshkurtra në strukturën e parasë, sipas Bankës së Shqipërisë, tregojnë zhvendosjen e strukturës kohore të saj drejt përbërësit më likuid, parasë jashtë bankave, si rezultat i mbajtjes së një pjese të depozitave të tërhequra jashtë sistemit. Stoku i depozitave totale rezultoi në nivelin 76% të agregatit M3 në dhjetor 2009, kundrejt nivelit 81% të shënuar në shtator të vitit 2008. Ndërsa Paraja jashtë korporatave depozituese në fund të dhjetorit 2009 ishte rreth 24% të parasë gjithsej, në nivele të njëjta me fundin e 2008-s.

## SISTEMI BANKAR

Sistemi bankar shqiptar ka ngadalësuar ndjeshëm ritmet e rritjes gjatë vitit 2009, pas tronditjes që filloi në tremujorin e fundit të 2008-s, kur bankat u përballën me një tërheqje të depozitave, rrjedhojë e panikut nga përhapja e krizës financiare globale. Efektet u ndien dhe më tej, teksa kriza financiare u shndërrua në një krizë të ekonomisë reale në mbarë globin dhe nuk la pa prekur edhe Shqipërinë. Rritja e ngadaltë e depozitave, tkurrja e kredisë u shoqëruan me një rritje të shpejtë të kredive me probleme, duke rritur shpenzimet për provigjione, çka ndikoi ndjeshëm në rezultatin neto të sistemit.

Totali i aktiveve të sistemit bankar në fund të vitit 2008 arriti në rreth 886 miliardë lekë, rreth 77.5% të PBB-së, me një rritje prej 6.3% në krahasim me vitin 2008 (nga rreth 12.3% që ishte rritja vjetore në vitin 2008), sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë. Pas një stanjacioni në dy tremujorët e parë të vitit, rritja e aktiveve u gjallërua disi në pjesën e dytë të vitit, e nxitur nga një përmirësim i kreditimit.

Pas rënies së depozitave në tremujorin e fundit 2008 dhe të parin 2009, sistemi bankar filloi ta marrë veten gradualisht, teksa depozitat shënuan një rritje graduale dhe të qëndrueshme deri në fund të vitit. Depozitat shënuan një rritje me bazë vjetore me rreth 7% gjatë 2009-s, duke mbetur në nivelin e rreth 58% të PBB-së. Pavarësisht rritjes graduale, në dhjetor 2009 ato ende nuk e kishin arritur nivelin e shtatorit 2008, momenti kur filloi dhe kriza financiare globale.

Paqëndrueshmëria e ecurisë së depozitave, sidomos në pjesën e parë të vitit ndikoi edhe veprimtarinë e ndërmjetësimit të sektorit bankar, duke u shoqëruar me ngadalësim të kredisë. Ritmet e rritjes së huasë ishin 13%, më të ulëta e viteve të fundit, nga 50% që ishte rritja mesatare vjetore në periudhën 2004-2007 dhe 35% në 2008-n, sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë. Ky ngadalësim reflektoi kujdesin e shtuar të bankave (forcimin e rregullave të kredidhënies dhe rritjen e interesave) sidomos në ata sektorë që u konsideruan me rrezik të

lartë nga njëra anë dhe nga ana tjetër një frenim të kërkesës së bizneseve e konsumatorëve për kredi. Kredia e re për ndërtimin dhe për pasuri të paluajtshme për individë shënoi dhe rënien më të madhe gjatë 2009-s. Në fund të dhjetorit 2009, stoku i kredisë për ekonominë arriti në rreth 440 miliardë lekë, rreth 38.5% të PBB-së.

Kredia me probleme shënoi një rritje të vazhdueshme gjatë gjithë 2009-s, duke arritur në 10.27% të totalit të huasë në fund të 2009-s, nga 6.46% në fund të 2008-s. Ngadalësimi i ritmeve të kredisë, problemet që bizneset apo individët hasën në përballimin e krizës ekonomike, shtrenjtimi i kësteve të kredisë në valutë si rrjedhojë e nënçmimit të lekut ishin disa nga arsyt kryesore që ndikuan në këtë përkeqësim të cilësisë së portofolit të huave. Pavarësisht masave të vazhdueshme të ndërmarra nga sistemi bankar për menaxhimin e huave me probleme, niveli i tyre vazhdoi të rritej edhe në tremujorin e parë të 2010-s, për të arritur në 11.5% të totalit të kredisë në fund të marsit 2010.

Rezultati financiar i sektorit bankar në fund të vitit 2009, ishte pozitiv për rreth 3.5 miliardë lekë, duke shënuar një rënie prej rreth 51% në krahasim me fundin e 2008-s. Rritja me 40% e shpenzimeve për provigjione ishte arsyeja kryesore që ndikoi në përkeqësimin e këtij rezultati, në një kohë kur të ardhurat e veprimtarisë ishin pothuajse në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Rezultati i ulët financiar ka ndikuar dhe në përkeqësimin e treguesve të kthyeshmërisë nga aktivet dhe të kapitalit të vet të sistemit bankar.

Kredia në valutë vazhdoi të dominonte strukturën e huasë sipas monedhës, duke përbërë 68% të stokut të kredisë në fund të vitit 2009, me një rënie të lehtë të peshës me tre pikë përqindjeje në krahasim me fundin e 2008-s. Pavarësisht uljes së normës ndërkombëtare të referencës (Euribor) gjatë vitit 2009, interesat e kredive në euro u rritën në tregun shqiptar, duke reflektuar rritjen e rrezikut të huasë në monedhën europiane. Bankat u orientuan gjatë 2009-s në dhënie të kredisë në lekë, stoku i të cilës u rrit me 23% me bazë vjetore gjatë 2009-s, nga 5% që u rrit kredia në valutë.

Në fund të vitit 2009, sistemi bankar shqiptar numëronte 16 banka të nivelit të dytë. Numri i degëve dhe agjencive bankare të sistemit bankar arriti në 533 në fund të vitit 2009, nga 509 në fund të vitit 2008, sipas të dhënave nga Shoqata e Bankave. Numri i punonjësve, nga 6332 në fund të vitit 2008 në 6384, një rritje minimale kjo ndryshe nga vitet e kaluara, kur sistemi bankar u zgjerua me ritme të shpejta.

#### TË DHËNAT PËR SEKTORIN BANKAR

	2006	2007	2008	2009
Totali aktiveve (milion lek)	624,410.5	742,543.2	833,681.5	886,309.0
totali aktiveve ndaj PBB	69.4	75.6	76.6	77.5
Totali huave ndaj PBB	21.7	29.7	35.7	38.5
Kredia për ekonominë ndaj totalit të aktiveve (%)	31.5	39.1	47.2	49.6
Totali huave (në milion Lek)	195,746.8	293,863.7	396,264.3	440,397.4
pesha e kredisë në lek	29%	27.70%	28.80%	31.90%
Pesha e kredisë në monedhë të huaj	71%	72.30%	71.20%	68.10%
Totali depozitave në milion lek	503,203.20	602,653.40	619,790.40	662,426
pesha e depozitave në lek	62.40%	58.30%	57.90%	55.70%
pesha e depozitave në monedhë të huaj	37.60%	41.70%	42.10%	44.30%
Rezultati neto (në miliard lek)	7.4	10.2	7.3	3.5
Raporti i kthimit nga aktivet (%)	1.5	1.57	0.91	0.42
Raporti i kthimit mbi kapitalin (%)	20.2	20.74	11.35	4.58
Norma e Mjaftueshmërisë së kapitalit (%)	18.1	17.08	17.23	16.17
Paraja jashtë korporatave depozituese (miliard lek)	163.0	154	195	209
Oferta e parasë (miliard lek)	666.0	757	815	871
PJB/oferta e parasë (%)	24.5	20.3	23.9	24

Burimi: Banka e Shqipërisë

### 3.1 NJË VËSHTRIM MBI SITUATËN FINANCIARE

Shifrat kryesore të Intesa Sanpaolo Bank Albania

në milion LEK

	2008	2009	Ndryshimi	Ndryshimi ne %
Të ardhura nga Interesi Neto	4,203	4,349	146	3%
Të ardhura jo nga Interesi	623	577	-46	-7%
Totali i të ardhurave	4,826	4,925	100	2%
Shpenzime Operacionale	(2,231)	(2,284)	(53)	2%
Fonde rezerve per huatë	(407)	(765)	(357)	88%
Të ardhura neto	1,776	1,618	(158)	-9%
Kthimi mbi aktivet	1.67%	1.46%	-0.21%	
Kthimi mbi kapitalin	28.49%	17.92%	-10.57%	
Raporti Shpenzime/ardhura	46.2%	46.4%	0.2%	
Totali i Aktiveve	107,126	114,385	7,259	7%
Totali i Huave	44,686	49,733	5,046	11%
Depozitat e klientit	90,399	97,428	7,029	8%
Totali i Kapitalit Aksioner	9,028	10,991	1,963	22%

### ANALIZA E DREJTIMIT

#### Ruajtja e rentabilitetit duke u fokusuar veçanërisht tek qëndrueshmëria, likuiditeti dhe profili i riskut.

Analiza që vijon bazohet në rezultatet sipas SNRF. Të gjitha shifrat janë të pasqyruara në milion Lek.

2009 kundrejt 2008


- Të ardhura nga Interesi Neto LEK 4,349 mln, rritje me 3.5% (2008:LEK 4,826 mln)
- Komisione neto LEK 564 mln, rënie me 6.7 % (2008: 605 mln)
- Rezultati i Këmbimeve Valutore LEK 285 mln, rënie me 8.8 % (2008: 312 mln)
- Marzhi Operacional Neto LEK 4,925 mln, rritje me 2.1% (2008:LEK 4,826 mln)
- Shpenzime Operacionale LEK 2,284 mln, rritje me 2.4% (2008: LEK 2,231mln)
- Të ardhura operacionale Neto LEK 2,641 mln, rritje me 1.8% (2008:LEK 2,595 mln)
- Fitimi pas tatimit Neto LEK 1,618 mln, 8.9% më pak (2008:LEK 1,776 mln)
- Raporti Kosto mbi të ardhura 46.4%, rritje me 0.2% (2008: 46.2%).

- Huatë për Klientët (Bruto) në fund të vitit 2009 ishin LEK 49,733 mln, një rritje me 11.3% nga viti i kaluar (Dhjetor 2008: LEK 44,686 mln)
- Depozitat e Klientëve në fund të vitit 2009 ishin LEK 97,428 mln, një rritje prej 7.8% nga viti i kaluar (Dhjetor 2008: LEK 90,399 mln)
- Totali i Kapitalit Aksioner në fund të vitit 2009 ishin Lek 10,991 mln, një rritje prej 21.7% nga viti i kaluar (Dhjetor 2008: LEK 9,028 mln)

Në lidhje me sfidat e mjedisit makroekonomik dhe bankar, si dhe me pershtatjen me politikën e Grupit Intesa Sanpaolo, Banka u përqendrua kryesisht në qëndrueshmërinë e likuiditetit dhe profilin e riskut.

Përsa i përket qëndrueshmërisë, Banka përmirësoi kapitalin nëpërmjet rritjes së strukturës së aktiveve drejt aktiveve të ponderuara me risk më të ulët. Prandaj, aktivet e ponderuara me risk u rritën vetëm me 6% gjatë 2009 në krahasim me rritjen e kapitalit rregullator më 13%. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit arriti 17.2% në fund të vitit 2009, i cili ishte 1% më i lartë se në 2008.

Duke qenë 75% të totalit të depozitave të klientit, financimet retail vazhduan të jenë komponenti kryesor i totalit të burimeve të financimit. Pas përballjes me rrjedhjen e depozitave në tremujorin e fundit të 2008 dhe tremujorin e parë të vitit 2009, Banka ishte në gjendje të ruante pozicionin e qëndrueshëm të likuiditetit nëpërmjet harmonizimit të rritjes së depozitave me rritjen e kredive në terma volumi, periudhën e maturimit dhe monedhën, si dhe duke u mbështetur më shumë në përmasat dhe sigurinë e Grupit Intesa Sanpaolo.



Në lidhje me raportin në ngritje të Huave me Probleme në Sektorin Bankar Shqiptar, kreditë për klientët iu akorduan klientëve të përzgjedhur. Vëmendje të veçantë iu kushtua profilit të riskut pasi Banka përmirësoi më tej analizën e riskut të kredisë, monitorimin e Huave me Probleme dhe proceset e rikuperimit të kredisë.



Ndër të tjerash, Banka u fokusua më shumë në rritjen e të ardhurave, optimizimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit. Prandaj, përmirësime u bënë në: shkurtimin e ciklit të kreditimit; reduktimin e kohës së disa aktiviteteve operacionale dhe rritjen e kohës së marketingut direkt; zhvillimin e aftësive të shitjes nëpërmjet trajnimeve; zhvillimit të sistemit të Menaxhimit të Marrëdhënës me Klientët; etj.

Viti 2009 ishte një vit i vështirë pothuajse në çdo aspekt. Pavarësisht kushteve shumë të vështira të tregut dhe kushteve ekonomike, Banka arriti të ruante fitimin në nivele të mira. Për vitin e plotë, Banka raportoi një fitim neto prej LEK 1.6 bln, duke pasqyruar forcën e ekskluzivitetit, menaxhimit të përmirësuar të aktivitetit dhe pasivit, menaxhimin strikt të kostove dhe menaxhimin të përforcuar të riskut.

Të nxitur nga rezultati pozitiv i të ardhurave neto, të ardhurat u rritën me 2.1% kundrejt vitit të kaluar. Rritja neto e të ardhurave nga interesi ishte 3.5% krahasuar me vitin 2008 pasi tregu filloi të rikuperohej në tremujorin e tretë të vitit 2009, duke sjellë nivele me të larta të volumit të aktiviteteve dhe nivele me të larta likuiditeti.

Duke qenë se raporti i fitimit ishte mbi mesataren e tregut, ROA prej 1.46% dhe ROE prej 17.92% kanë rënë në krahasim me vitin 2008, kryesisht si rezultat i ngadalësimit ekonomik, trendi i pafavorshëm i normave ndërkombëtare të interesit dhe politika e provigjionimit të kujdesshëm.

Në kuadrin e njohjeve të limiteve të të ardhurave, Banka shfrytëzoi shumë mundësitë për reduktimin e shpenzimeve dhe u fokusua veçanërisht në kontrollin e kostos.



Për rrjedhojë raporti shpenzime- të ardhura ishte i qëndrueshëm. Ky raport është raporti më i ulët në sektorin bankar dhe shumë më i ulët se mesatarja e tregut




Gjatë vitit 2009, rënia e madhe e normës ndërkombëtare ushtroi një tryzni në rënie tek të ardhurat nga interesi. Banka morri masa të menjëhershme lidhur me rritjen e spreadit për monedhën e huaj.

Pavarësisht nga rënia e spreadit për klient me 59 bp (nga 5.55% për 2008 në 4.96% për 2009), Banka mbajti pothuajse të qëndrueshëm spreadin global (2009: 3.77%) duke vazhduar optimizimin e strukturës së aktiveve që fitojnë interes dhe duke reduktuar koston e financimit.

Të ardhurat e Bankës nga interesi ishin afërsisht si në vitin 2008, pasi Banka arriti të rikuperojë rënien në normën mesatare të portofolit të kredisë me përmirësimin e normës mesatare në portofolin e letrave me vlerë dhe me rritjen e volumit të aktiveve që fitojnë interes.


Në të njëjtën kohë shpenzimet e interesit u ulën me 2.8% pasi vëmendje iu kushtua me shumë monitorimit të kujdesshëm të normave që ofroheshin.




Në mënyrë të ngjashme, në përgjigje të tendencës në rënie të normave ndërkombëtare, Banka rishikoi të gjitha kushtet e punës për të trajtuar ndikimin negativ të kushteve jo të favorshme ekonomike në rezultatet e komisioneve. Megjithatë, të ardhurat neto nga komisionet rezultuan 6.7% më ulët se rezultatet e vitit 2008.

Komisionet e pakta nga pagesat dhe huatë ishin kryesisht rezultat i rënies së volumit dhe numrit të transaksioneve të biznesit të kryera nga klientët e bankës veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Kjo rënie, krahas ngushtimit të vazhdueshëm të spreadit solli një rezultat këmbimi valuator prej 8.8% më të ulët se në vitin 2008.

Megjithatë një rikuperim gradual u evidentua gjatë vitit 2009.



Gjatë vitit 2009, Banka kishte si qëllim racionalizimin e operacioneve dhe burimeve. Për rrjedhojë, Banka reduktoi lehtë rritjen dhe numrin e punonjësve.



Në krahasim me vitin e kaluar, Banka kishte shpenzime më të larta personeli lidhur me personelin e marrë nga Kompanitë e Grupit si dhe shpenzime të larta të përkohshme personeli.


Në sajë të kontrolleve rigorozë dhe një seri iniciativave të shkurtimit të shpenzimeve, shpenzimet u mbajtën në nivele optimale. Banka përfitoi shkurtimin e shpenzimeve nga rishikimi i kontratave dhe marrëveshjeve me furnitorët dhe nga përdorimi i ekonomisë së shkallës në fazën e prokurimit. Si rezultat, shpenzimet tona administrative u zvogëluan me 4.8% krahasuar me vitin e kaluar.

Në të njëjtën kohë, Banka vazhdoi të investonte në teknologji për të mbështetur rritjen, shtimin e sistemeve të informacionit të biznesit, dhe mbështetur menaxhimin e riskut si dhe për të qenë në përputhje me kuadrin rregullator të Grupit. Prandaj shpenzimet e zhvlerësimit mbeten në të njëjtin nivel me vitin e kaluar.

SHPENZIME PER PERSONELIN

SHPENZIME ADMINISTRATIVE

SHPENZIME NGA AMORTIZIMI



Duke qenë se raporti i Huave me probleme (kuadri rregullator i BSH-së) në sektorin bankar u përkeqësua nga 6.6% në 10.5%, raporti i huave me probleme të Bankës u rrit nga 4.5% në 9.1%. Kjo rritje u pasqyrua edhe në klasifikimin sipas SNRF.

## PRITSHMËRIA PËR TË ARDHMEN

Kuadri i masave energjike të marra gjatë vitit 2009, pritet të ketë ndikim të madh në vitin 2010. Prandaj, pavarësisht nga kushtet e pasigurta makroekonomike, Banka beson se viti 2010 do të jetë vit me rezultate pozitive për Aksionerët.

## MARRËDHËNIA ME KLIENTËT TANË

Duke qenë i klasifikuar midis grupeve kryesore bankare të Eurozonës, Grupi Intesa Sanpaolo arrin gjithmonë me sukses t'i kushtojë vëmendje kërkesave lokale gjatë hartimit të strategjive globale. Ky detaj kaq i rëndësishëm e përfron Grupin edhe më shumë me 19.7 milionë klientë që ndodhen në katër kontinentet, në të gjitha anët e botës ku bankat tregtare, degët dhe zyrat e përfaqësimit të grupit janë vendosur.

Iniciativa e Grupit Intesa Sanpaolo, "Ju dëgjojmë 100%", e cila fokusohet në dëgjimin e zërit të klientëve u zbatua në të gjitha vendet ku operon Grupi nëpërmjet bankave tregtare. Në Shqipëri, kjo iniciativë u prezantua në vitin 2008 dhe u konsolidua në vitin 2009. Iniciativa "Ju dëgjojmë 100%" rezultoi jo vetëm e suksesshme në vendosjen e një mënyrë komunikimi të hapur me klientët tanë, por edhe në gjenerimin e plan veprimeve dhe gjetjen e mënyrave për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve bankare. Pjesë e kësaj iniciative ishin një seri takimesh e trajnimesh si "Programi i Edukimit – Ju dëgjojmë 100%" ku përfshihen mësimet e marra dhe hapat që duhet të ndiqen në të ardhmen. Rezultatet në vitin 2009 menjëherë revolucionizuan mënyrën e të menduarit, sjelljen dhe reagimin e shpejtë të bankës drejt përmirësimit të kohës dhe cilësisë së shërbimit tek Shërbimi me Klientët, përmirësimit të procedurave për miratimin e kredisë dhe forcimin e besnikërisë së klientit.

Pas përbaljes me sfidat ekonomike të vitit 2009, Grupi Intesa Sanpaolo gjatë muajit Shtator inicioi në të gjithë Europën dhe rajonin e Mesdheut, fushatën ndërkombëtare të komunikimit "Me sytë mbyllur", nëpërmjet të cilës vlera e besimit reciprok është guri i themelit të një marrëdhënieje solide midis bankës dhe klientit. Projekti për reklamimin u shndërua në një strategji ndërkombëtare të komunikimit duke bashkuar të gjitha bankat e huaja që i përkasin Grupit Intesa Sanpaolo së bashku – të fokusuar në shenjë universale të besimit, një dëshmi e marrëdhënieve solide midis protagonistëve të cilët bashkëveprojnë me besim të plotë tek njëri-tjetri. Laitmotivet e fushatës janë, 'Zbuloni një të ardhme të ndërtuar mbi besimin' dhe 'Marrëdhëniet solide mbështeten në besim.'

Një nga arritjet kryesore të vitit 2009 ishte projekti pilot, 'Perceptimi i Klientit', i cili zgjati 5 muaj dhe vendosi baza të forta për instrumentet e Menaxhimit të Marrëdhënieve me Klientët dhe analizën që do të përdoret dhe eksperimentohet nga Divizionit për Shërbimet dhe Produktet Bankare për individë. Departamenti i CRM (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientët) filloi aplikimin e një metode inovatore për nën-segmentimin dhe përgatitjen e fushatave të dedikuara për klientët e synuar.

Të kuptuarit më mirë të nevojave të klientëve u pasqyrua gjithashtu edhe në përmirësimin dhe zgjerimin e gamës së produkteve dhe shërbimeve të ofruara gjatë vitit 2009. Intesa Sanpaolo Bank Albania u angazhua në disa iniciativa të cilat kishin për qëllim thjeshtëzimin e proceseve, duke përshpejtuar procedurat për t'i shërbyer më mirë klientëve dhe në arritjen e standartave mbi cilësinë e shërbimit në nivel Grupi.

Banka rriti numrin e marrëveshjeve bilaterale me kompanitë utilitare, kompanitë e telefonisë fikse dhe celulare duke lehtësuar në këtë mënyrë pagesën e faturave mujore nga klientët nëpërmjet Bankës si dhe zbatimin e disa marrëveshjeve të ndryshme të debitimit automatik. Viti 2009 solli për klientët një shërbim të përmirësuar dhe mjaft të lehtë për t'u përdorur të kryerjes së veprimeve bankare nëpërmjet internetit, duke mundësuar kështu një menaxhim më të mirë të llogarive personale dhe duke ofruar siguri të lartë gjatë kryerjes së transaksioneve nëpërmjet internetit.

Njësia e Zhvillimit të Produktit, në vijim të ndjekjes së zhvillimeve të tregut dhe përshtatjes së tyre sipas nevojave të klientit, në vitin 2009 zhvilloi produktin Depozita Stafete, një depozitë progresive e cila ofron çdo muaj një interes më të lartë, si dhe kredinë Mozaik, një kredi afatshkurtër, e thjeshtë dhe fleksibël për të plotësuar sa më mirë nevojat e ndryshme të klientit. Banka e përqendruar në efikasitetin e rrjetit ekzistues zgjeroi rrjetin bankar me një Degë të re në Lezhë.

Viti 2009 u karakterizua gjithashtu nga racionalizimi i kostove dhe shpenzimeve. Në këtë kontekst, zbatimi i një politike të re për prokurimin dhe funksionimi i Komitetit të Prokurimeve u ofruan furnitorëve ekzistues mundësi për forcimin e marrëdhënies së tyre me bankën si dhe furnitorëve të rinj u krijoi mundësi për të hyrë në marrëdhënie me bankën falë transparencës së blerjeve dhe rinovimit të kontratave të ndryshme.

## MARRËDHËNIET ME PUNONJËSIT TANË

Gjatë vitit 2009, punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania kanë marrë pjesë në mënyre aktive në fushatën e brendshme të Grupit për shtatë vlerat e përbashkëta si transparenca, të vepruarit drejt, barazia, të dëgjuarit me kujdes, respektimi i ndryshimeve, të qenurit të përgjegjshëm dhe përmirësimi i cilësisë. Secila vlerë është thelbësore për zhvillimin e një mjedisi pune ku përfituesit janë si punonjësit ashtu edhe dhe klientët e bankës.

Një hap i rëndësishëm ishte gjithashtu ndërmarrja e një iniciative institucionale të ngjashme me programin "Ju dëgjojmë 100%", e njohur si Sondazhi për Klimën e Brendshme, nëpërmjet të cilës synohej që të gjithë punonjësit të ndanin opinionet dhe vlerësimet e tyre në lidhje me pikat kryesore e strategjike të bankës. Sondazhi për Klimën e Brendshme 2009 bazohet në metodologjinë e aplikuar në Itali që në vitin 2007 dhe 325 punonjës ose 63% e tyre iu përgjigjën kësaj iniciative. Duke marrë në konsideratë komunikimin e punonjësve dhe duke qenë se është informacion mjaft me vlerë dhe strategjik për arritjen e objektivave afatgjatë të organizimit, Sondazhi për Klimën e Brendshme do të zhvillohet çdo vit rregullisht për të zhvilluar më tej procesin e përmirësimit ndaj të cilit banka angazhohet maksimalisht.

Burimet Njerëzore ka qënë një nga shtyllat kryesore ku Banka investoi gjatë vitit 2009. Nga proaktiviteti drejt veprimit komercial– ky ishte slogani i programit të iniciuar për trajnimin e konsulentëve të shitjeve SME dhe Drejtorët e Degëve me synim përmirësimin e mëtejshëm të aftësive dhe teknikave të tyre komerciale, optimizimin e marrëdhënies me klientet dhe për favorizimin e qëndrimit proaktiv në planifikimin e aktivitetit komercial. Programi do të vazhdojë edhe në vitin 2010 dhe do të kryhet me pjesëmarrjen e njësisë së "Fluxus HR" dhe "Shërbimit të Formimit" të Intesa Sanpaolo.

Një tjetër iniciativë e Grupit, Programi për Zhvillimin e Lidërsipit, filloi në vitin 2009 duke përfshirë linjën e parë dhe linjën e dytë të drejtimit. Gjatë pjesës së parë të programit, linjat e menaxhimit të Divizionit Ndërkombëtar u prezantuan me Modelin e Aftësisë së Grupit me qëllim identifikimin e pikave të forta dhe atyre për t'u përmisuar. Në vecanti, iniciativa e reagimit 360 gradë synoi të jepte më shumë njohuri mbi aftësitë menaxheriale, kjo bazuar si në perceptimet e vetë menaxherëve edhe të atyre që punojnë më afër me to. Bazuar mbi këtë kontroll skuadra drejtuese është gati të vazhdojë me pjesën e dytë të Programit të Zhvillimit të Lidërsipit gjatë 2010.

Banka jo vetëm që i kushton vëmendje performancës ditore në punë të stafit, por kujdeset edhe për jetët e tyre private, të fëmijëve dhe familjeve të tyre, me qëllim ruajtjen e balancave të drejta mes jetës private dhe asaj profesionale. Në kuadrin e promovimit të punës në skuadër, banka mbështet një seri aktivitesh sociale dhe kulturore që organizohen gjatë gjithë vitit. Grupi gjithashtu vë në zgjedhje të kujtdo nga stafi një seri eventesh ndërkombëtare të zgjedhura me shumë kujdes në fushën e muzikës, modës, sportit, artit dhe kulturës, evente këto të njohura gjerësisht si eventet e Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Vartëse.

Po në vitin 2009, skuadrat e bankës të vollejbolit për femra dhe futbollit për meshkuj ruajtën traditën e pjesëmarrjes në kampionatet e Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Vartëse ku pjesëmarrësë janë të gjithë skuadrat sportive bankare anëmbanë. Me të njëjtën frymë, fëmijët e stafit u dërguan në Follonica-Itali, në një fshat turistik ku të pranishëm ishin të gjithë fëmijet e Grupit Intesa Sanpaolo.

## MARRËDHËNIA ME SHOQËRINË

Edhe gjatë vitit 2009, banka vazhdoi të luajë rolin e saj në mbështetje të plotë të aktiviteteve me fokus tek fëmijët dhe familjet e tyre, sic janë Milan Park dhe Milan Junior Camp.

Një arritje e vecantë ishte bashkëpunimi me një program ndërkombëtar, "Intercultura", dedikuar të rinjve nën 17 vjeç të cilët studiojnë për një vit në një shkolle të mesme në Itali. Iniciativa e studimit dhe jetesës për një vit në Itali, e ndërmarrë nga Grupi Intesa Sanpaolo njohu për të parën herë edhe një pjesëmarrës nga Shqipëria. Kjo u arrit falë ndihmës financiare që Banka jonë ofroi për të përzgjedhurin. Pjesëmarrësi është ende duke studiuar dhe njëkohësisht jetuar pranë një familjeje Italiane në rajonin e Napolit, Itali.

Mbështetje signifikative kanë përfituar edhe iniciativat e ndryshme të ndërmarra në fushën e bamirësisë, promovimit të vlerave dhe kulturës kombëtare dhe të arsimimit.




KAPITULLI



RAPORTI  
I AUDITORIT  
TE PAVARUR





**Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.**

**Pasqyrat financiare te konsoliduara  
per periudhen deri me 31 Dhjetor 2009  
(me raportin e audituesve te pavarur)**

** ERNST & YOUNG**



*Ky eshte perkthimi ne Shqip i raportit te leshuar fillimisht ne Anglisht  
(vetem per qellime te manaxhimit)*

## **RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR PER AKSIONERET E BANKES INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te konsoliduara bashkelidhur te Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a. ("Banka"), te cilat permbajne pasqyren e konsoliduar te pozicionit financiar me date 31 Dhjetor 2009, pasqyren e konsoliduar te te ardhurave dhe pasqyren e konsoliduar te te ardhurave gjitheperfshirese, pasqyren e konsoliduar te ndryshimeve te kapitalit, dhe pasqyren e konsoliduar te fluksit te parase per ushtrimin e mbyllur ne kete date, dhe nje permbledhje te politikave te rendesishme kontabel si dhe shenime te tjera sqaruese.

### **Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF). Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit te brendshem, i cili eshte i rendesishem per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali materiale, qe mund te jene pasoje e mashtrimit apo e gabimeve; perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabel te duhura; dhe berjen e cmuarjeve kontabel te cilat jane te arsyeshme per rrethanat.

### **Pergjegjesia e Audituesve**

Pergjegjesia jone eshte qe, duke u bazuar ne auditimin tone, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe ne t'u permbahemi kerkesave etike te pershtatshme, dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin per te fituar siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidence qe mbeshtet tepricat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura jane ne varesi te gjykimit tone, perfshire ketu vleresimin e rreziqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Ne kryerjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, ne shqyrtojme kontrollin e brendshem, i cili eshte i rendesishem per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare, me qellim hartimin e procedurave te auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por qe nuk kane per qellim shprehjen e nje opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e pershtatshmerise se parimeve kontabel te perdorura dhe te cmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidencia e auditimit jep nje baze te mjaftueshme dhe te pershtatshme per opinionin tone.

### **Opinionit**

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te konsoliduara japin nje pamje te vertete dhe te drejte per gjendjen financiare te Intesa Sanpaolo Bank Albania me date 31 Dhjetor 2009, dhe per ecurine financiare te saj, dhe fluksin e parase per ushtrimin e mbyllur, ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k. Skopje – Tirana Branch

*Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k.*


17 Mars 2010

## PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR ME 31 DHJETOR

(NE '000 LEK)

	Shënime	2009	2008
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe te ngjashme	8	5,742,645	4,497,583
Hua dhe paradhanie bankave	9	8,686,240	8,215,701
Letra me vlere te vendosjes	10	2,643,232	1,963,807
Letra me vlere te investimit	11	47,016,899	46,065,994
Hua dhe paradhanie klienteve	12	47,490,960	43,415,104
Ndertesat dhe pajisje	13	1,862,884	2,027,981
Aktive afatgjata jomateriale	14	289,771	195,921
Te drejta tatimore te shtyra	19	39,678	39,394
Te drejta tatimore korrente		178,709	150,866
Mjete te tjera	15	433,743	553,262
<b>Aktive gjithsej</b>		<b>114,384,761</b>	<b>107,125,613</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime ndaj bankave	16	4,554,716	6,489,442
Detyrime ndaj klienteve	17	97,427,503	90,399,380
Llogari rrjedhese		26,161,276	24,216,368
Depozita me afat		71,266,227	66,183,012
Borxhi i varur	18	529,471	481,811
Detyrime tatimore korrente		41,346	77,740
Detyrime tatimore te shtyra	19	42,187	14,889
Provizione	20	187,786	176,629
Detyrime te tjera	21	610,794	457,528
<b>Detyrime gjithsej</b>		<b>103,393,803</b>	<b>98,097,419</b>
<b>KAPITALI AKSIONER</b>			
Kapitali i nenshkruar i paguar	22	5,562,518	5,562,518
Primet e aksioneve	22	1,383,880	1,383,880
Rezerva ligjore dhe rregullative	23	1,347,176	1,258,387
Rezerva per letrat me vlere te vendosjes		(889,309)	(1,285,725)
Diferenca e rivleresimit nga kurset e kembimit		106,952	6,389
Diferenca te tjera rivleresimi	24	714,555	714,555
Fitimi i pashperndare		2,765,186	1,388,190
<b>Totali i Kapitalit Aksioner</b>		<b>10,990,958</b>	<b>9,028,194</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksioner</b>		<b>114,384,761</b>	<b>107,125,613</b>

Shënimet nga faqa 8 deri ne 73 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare të konsoliduara.

  
 Stefano Farabbi  
 Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

  
 Adela Xhemali  
 Drejtore e Kontrollit Financiar


**PASQYRA E KONSOLIDUAR E TE ARDHURAVE DHE  
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TE ARDHURAVE  
GJITHEPERFSHIRESE DERI ME 31 DHJETOR**

(NE '000 LEK)

	Shënime	2009	2008
Te ardhura nga interesi		7,811,838	7,765,638
Shpenzime interesi		(3,463,147)	(3,562,523)
Te ardhura nga interesi, neto	25	4,348,691	4,203,115
Te ardhura nga komisionet		716,027	744,030
Shpenzime per komisionet		(151,862)	(139,136)
Te ardhura nga komisionet, neto	26	564,165	604,894
Te ardhura bankare nga tregtueshmeria, neto	27	284,733	312,106
Te ardhura / (shpenzime) te tjera operative, neto	28	(176,611)	(131,887)
Te ardhura operative		5,020,978	4,988,228
Humbje nga zhvleresimi i mjeteve financiare, neto	12	(771,489)	(437,232)
Shpenzime personeli	29	(1,010,351)	(929,811)
Shpenzime qeraje operationale	33	(170,844)	(211,648)
Zhvleresimi dhe amortizimi	13,14	(358,036)	(356,103)
Amortizimi i permiresimeve te ambienteve me qira	15	(101,972)	(154,034)
Shpenzime te tjera administrative	30	(744,728)	(754,526)
Provizione per rreziqe dhe shpenzime	20	(80,813)	-
Totali i shpenzimeve		(3,238,233)	(2,843,354)
Fitimi neto para tatimit		1,782,745	2,144,874
Tatimi mbi fitimin	31	(164,524)	(369,096)
Fitimi per periudhen		1,618,221	1,775,778

	Notes	2009	2008
Fitimi per periudhen		1,618,221	1,775,778
Te ardhura te tjera gjithepershiresë			
Ndryshimi neto ne vleren e drejte te Letrave me Vlere te Vendosjes	24	396,416	(795,223)
Efekti i tatimit mbi fitimin		(39,642)	79,522
Te ardhura te tjera gjithepershiresë per periudhen, neto		356,774	(715,701)
Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë per periudhen, neto		1,974,995	1,060,077

Shenimet nga faqa 8 deri ne 73 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara

  
Stefano Farabbi  
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv

  
Adela Xhemali  
Drejtoresh e Kontrollit Financiar

**PASQYRA FINANCIARE E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE  
NE KAPITAL DERI ME 31 DHJETOR 2009**

(NE '000 LEK)

	Kapitali i paguar	Primet e aksioneve	Rezervat		Rezervat e vleresimit			Fitimi i vitit	Totali
			Retained earnings	Statutory, General and Legal reserve	Available for Sale reserve	Foreign Currency Translation reserve	Comprehensive item		
<b>Gjendja me 1 Janar 2008</b>	<b>4,309,675</b>	-	<b>(483,605)</b>	<b>1,231,421</b>	<b>(490,502)</b>	<b>28,416</b>	<b>714,555</b>	900,465	<b>6,210,425</b>
Rritja e kapitalit aksioner	446,250	1,383,880	-	-	-	-	-	-	1,830,130
Transferimi i fitimit vjetor			900,465					900,465	-
Kalimi i fitimit te mbartur	806,593	-	(833,559)	26,966	-	-	-	-	-
Te ardhura te tjera gjithepershireshe (Ndryshimi ne vleren e investimit ne letra me vlere te vendosjes, neto)	-	-	-	-	(795,223)	-	-	-	(795,223)
Diferenca valutore e rivleresimit	-	-	29,111	-	-	(22,027)	-	-	7,084
<b>Fitimi i vitit</b>	-	-	-	-	-	-	-	<b>1,775,778</b>	<b>1,775,778</b>
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2008</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>(387,588)</b>	<b>1,258,387</b>	<b>(1,285,725)</b>	<b>6,389</b>	<b>714,555</b>	<b>1,775,778</b>	<b>9,028,194</b>

**PASQYRA FINANCIARE E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE  
NE KAPITAL DERI ME 31 DHJETOR 2009**

(NE '000 LEK)

	Kapitali i paguar	Primet e aksioneve	Rezervat		Rezervat e vleresimit			Fitimi i vitit	Totali
			Retained earnings	Statutory, General and Legal reserve	Available for Sale reserve	Foreign Currency Translation reserve	Comprehensive item		
<b>Gjendja me 1 Janar 2009</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>(387,588)</b>	<b>1,258,387</b>	<b>(1,285,725)</b>	<b>6,389</b>	<b>714,555</b>	<b>1,775,778</b>	<b>9,028,194</b>
Rritja e kapitalit aksioner									-
Transferimi i fitimit vjetor			1,775,778					(1,775,778)	-
Kalimi i fitimit te mbartur			(88,789)	88,789					-
Te ardhura te tjera gjithepershiresh (Ndryshimi ne vleren e investimit ne letra me vlere te vendosjes, neto)					396,416				396,416
Diferenca valutore e rivleresimit			(152,436)			100,563			(51,873)
Fitimi i vitit								1,618,221	1,618,221
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2009</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>1,146,965</b>	<b>1,347,176</b>	<b>(889,309)</b>	<b>106,952</b>	<b>714,555</b>	<b>1,618,221</b>	<b>10,990,958</b>

Shenimet nga faqa 8 deri ne 73 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara.



Stefano Farabbi  
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv



Adela Xhemali  
Drejtoresh e Kontrollit Financiar

## PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE DERI ME 31 DHJETOR

(NE '000 LEK)

	2009	2008
<b>Fluksi i parase nga/(ne) aktivitetet operative</b>		
Fitimi neto	1,618,221	1,775,778
Zerat qe rakordojne fitimin para tatimit me mjetet monetare neto te perdorura ne aktivitetet operacionale		
Zhvleresimi i ndertesave dhe pajisjeve	246,176	253,801
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	92,995	68,729
Zhvleresimi i permiresimeve te ambienteve me qira	101,972	154,034
Shitja e aktiveve afatgjata jomateriale	409	-
Shitja e ndertesave dhe pajisjeve	18,456	21,564
Amortizimi i investimeve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim- bono thesari	(152,099)	(336,522)
Amortizimi i investimeve ne letra me vlere te mbajtura deri ne maturim- te ndryshme nga bono thesari	(112,620)	(436,199)
Amortizimi i letrave me vlere te vendosjes	934	(9,342)
Humbje nga zhvleresimi i mjeteve financiare	771,489	437,232
Pakesimi (rritje) ne interesin per t'u arketuar	(121,902)	(7,319)
Rritje(pakesim) ne interesin per t'u paguar	42,621	313,198
Diferenca nga ndryshimi i kursit te kembimit	25,598	(38,947)
<b>Ndryshime ne aktive dhe detyrime operative</b>		
Ndryshimi ne tregtimin e letrave me vlere te vendosjes	-	-
Ndryshime ne hua dhe paradhenie bankave	(472,227)	4,282,335
Ndryshime ne hua dhe paradhenie klienteve	(4,746,824)	(4,990,733)
Ndryshime ne aktive te tjera	28,954	(24,727)
Ndryshime ne aktive tatimore te shtyra	6,106	(976)
Ndryshime ne detyrime ndaj bankave	(1,932,972)	2,212,009
Ndryshime ne detyrime ndaj klienteve	6,977,600	(3,297,301)
Ndryshime ne detyrime te tjera dhe provizione	164,424	(40,014)
Ndryshime ne detyrime tatimore te shtyra	27,298	(6,339)
Ndryshime ne tatime korrente	(64,237)	54,168
<b>Fluksi neto i parase nga aktivitetet operative</b>	<b>902,150</b>	<b>(1,391,349)</b>
<b>Fluksi i parase nga aktivitetet investuese</b>		
Shitja (blerja) e aktiveve afatgjata jomateriale	(175,065)	(141,257)
Shitja (blerja) e ndertesave dhe pajisjeve	(183,923)	(841,262)
Shitja (blerja) e letrave me vlere te vendosjes	(283,943)	(155,286)
Shitja (blerja) e letrave me vlere te mbajtura deri ne maturim	(686,186)	(4,594,584)
Fluksi neto i parase nga aktivitetet investuese	(1,329,117)	(5,732,389)
Rrjedhja neto e parase nga aktivitetet financuese		
Zmadhimi (zvogelimi) i borxhit te varur	53,808	(417,310)
Emetim i kapitalit aksioner	-	1,830,130
Fluksi neto i parase nga aktivitetet e financuese	53,808	1,412,820
Ndryshimi i mjeteve monetare gjate periudhes	1,245,062	(3,935,140)

Mjete monetare e te ngjashme ne fillim te periudhes	4,497,583	4,847,434
Efekti i bashkimit	-	3,585,289
<b>Mjete monetare e te ngjashme ne fund te periudhes</b>	<b>5,742,645</b>	<b>4,497,583</b>
Fluksi i parase nga interesat:		
Interesa te paguara	3,417,017	3,249,325
Interesa te arketuara	7,426,151	7,758,319

Gjate vitit 2009 Banka pagoi si Tatim Fitimi, per vitin aktual, nje shume totale prej Lek 225,360 mije (2008: Lek 294,519 mije per vitin aktual dhe vitet e meparshme).

Shenimet nga faqa 8 deri ne 73 jane pjese integrale e pasqyrave financiare te konsoliduara.

Keto pasqyra financiare jane miratuar nga Keshilli Drejtues i Bankes ne 9 Mars 2010. Pas nxjerrjes se tyre, çdo ndryshim eshte kompetence e Aksionereve te Bankes. Pasqyrat financiare jane firmosur ne emer te Bankes nga:



Stefano Farabbi  
Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv



Adela Xhemali  
Drejtore e Kontrollit Financiar

## 1. SUBJEKTI RAPORTUES

Intesa Sanpaolo Bank Albania, (më poshtë referuar "Banka"), themeluar në Maj të vitit 1998, u autorizua që të ushtronte aktivitet bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365, "Për Sistemin Bankar në Shqipëri", që daton në 2 Korrik 1998, i cili u zëvendësua nga Ligji nr. 9662 "Për Bankat në Shqipëri", datë 18 Dhjetor 2006, i cili hyri në fuqi në Qershor 2007. Banka e filloi aktivitetin e vetë më 24 Shtator 1998.

Me 20-21 Dhjetor 2006, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (më poshtë referuar "FSHAN") në cilësinë e tij si aksioneri i vetëm i Bankës, firmosi një marrëveshje për Shitblerjen e Aksionëve (më poshtë referuar "Marrëveshja e Blerjes") me SANPAOLO IMI s.p.a ("Blerësi"), një kompani e themeluar në përputhje me Ligjet e Republikës Italiane, me synimin e shitjes të 12,000,000 aksionëve të Bankës me një vlerë nominale prej 2.2266 USD që përbënte rreth 80% të vlerës totale të kapitalit të Bankës, kundrejt një çmimi prej 125,520 mijë USD ("Çmimi i Blerjes"). Më 1 Janar 2007, SANPAOLO IMI s.p.a dhe Banca Intesa S.p.a krijuan Intesa Sanpaolo S.p.a nëpërmjet bashkimit të dy bankave. Në 29 Qershor 2007, Data e Mbylljes e përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes, pas plotësimit të gjitha kushtëve, përfaqësuesit e FSHAN dhe të Intesa Sanpaolo s.p.a nënshkruan transferimin e aksionëve.

Banka dhe Banka Italo Albanëse Sh.a. (e njohur si Banka Italo Shqiptare osë BIA) u bashkuan nëpërmjet përthithjes së aktiveve dhe pasiveve të BIA në aktivitetët e Intesa Sanpaolo Bank Albania. Të gjithë aksionerët miratuan tërmat dhe kushtët e bashkimit, sipas Planit të Bashkimit dhe Marrëveshjes për Bashkim në datën 6 Nëntor 2007 dhe Shtojcës datë 4 Dhjetor 2007. Kursi i këmbimit të aksionëve u përcaktua sipas metodologjisë për vlerën kontabël të rregulluar nëto (vlera e rregulluar e aktivitetit) në bazë të pjesëmarrjes së aksionerëve dhe vlerësimit përkatës të situatës financiare të secilës Bankë me 30 Qershor 2007, si një përqindje e vlerësimit të kombinuar të të dy bankave në të njëjtën datë, pavarësisht numrit të aksionëve që do të regjistroheshin.

Në datën 04 Gusht 2009, Intesa Sanpaolo S.p.a ("Blerësi") në cilësinë e aksionerit kryesor të Bankës, nënshkroi një Marrëveshje për Shitblerjen e Aksionëve me Fondin Shqiptaro – Amerikan të Ndërmarrjeve, për transferimin e pronësisë së 1,751,283 aksionëve dhe në datën 14 Gusht 2009 të dyja palët nënshkruan Deklaratën Përfundimtare ku pranonin përmbushjen e kushtëve kontraktuale, duke përfunduar këtë transaksion. Detaje të pjesëmarrjes së Aksionerëve paraqitën në Shënimin 22.

Banka, me seli në Tiranë, në adresën Rruga "Ismail Qemali", nr.27, operon nëpërmjet një rrjeti të përbërë nga 36 degë dhe agjensi në qytetë të ndryshme të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Lushnjë, etj, dhe gjithashtu në Greqi me katër degë në Athinë, Sëlanik, Përistëri dhe Pire (2008: 37 degë dhe agjenci).

Në 31 Dhjetor 2009 Banka numërontë 515 punonjës (2008: 511).

Pas marrjes së miratimit përfundimtar të Bankës së Shqipërisë, nga data 13 Tëtor 2008 emri i Bankës u ndryshua nga Banka Amerikanë e Shqipërisë në Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës deri me 31 Dhjetor 2009 dhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, përfshijnë gjithashtu filialin në Greqi (degët në Greqi), i cili operon si subjekt ligjor më vetë.



## 2. BAZAT E PREGATITJES

### 3. Deklaratë për përputhshmërinë rregullative

Në përputhje me legjislacionin kontabël vendas, pasqyrat financiare të konsoliduara janë pregatitur sipas Standartëve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

#### (a) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pregatitur në përputhje me parimin e kostos historike, duke bërë përjashtim vetëm për mjetët financiare të letrave me vlerë të vendosjes, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

#### (b) Monëdha funksionale dhe raportuesë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të raportuara në Lek, e cila është në të njëjtën kohë edhe monëdha funksionale e Bankës.

Diferencat e konvertimit përfshijnë të gjitha diferencat nga kursët e këmbimit si pasojë e konvertimit të pasqyrave financiare të veprimtarisë së filialit të huaj në monëdhën funksionale dhe raportuesë të Bankës. Monëdha funksionale e degëve të Greqisë është Euro.

Me përjashtim të rastëve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në Lek është rumbullakosur në të mjtën më të afërt.

#### (c) Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Bankës dhe filialeve të saj për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor.

##### (i) Filialet

Filialet janë entitetë të cilat janë të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka të drejtë të drejtojë politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të përfitojë të mira prej ushtrimit të aktivitetit të tij. Gjatë vlerësimit të kontrollit, të drejtat e votës që ushtrohen aktualisht, janë marrë në konsideratë. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të ushtrimit të kontrollit deri në datën që ky kontroll merr fund.

##### (ii) Transaksionët e eliminuara gjatë konsolidimit

Tëpricat që rrjedhin nga marrëdhënie brenda grupit, dhe të ardhurat e shpenzimet e përealizuara që burojnë nga transaksionë brenda grupit, janë eliminuar në momentin që janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara. Të ardhurat e përealizuara janë eliminuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara. Shpenzimet e përealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e përealizuara, por vetëm në atë masë kur nuk ka tregues për zhvlerësim.

##### (iii) Bashkimi me entitetë nën të njëjtin kontroll

Bashkimi me përthithje i Bankës me BIA u kontabilizua më 1 Janar 2008, sipas përcaktimit në marrëveshjen e bashkimit. Mjetët dhe detyrimet e marra janë njohur në vlerën e tyre kontabël, të njohur më parë në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit të aksionërëve nën kontrollin e tyre.

### 3. PËRDORIMI I ÇMUARJEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL

Gjatë procesit të zbatimit të politikave kontabël të Bankës, Drejtimi ka përdorur gjykimet dhe çmuarjet në përcaktimin e shumave që njihen në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe çmuarjeve janë si më poshtë:

#### (a) Vijimësia

Drejtimi i Bankës ka vlerësuar mundësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi dhe është i kënaqur që banka ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale të cilat mund të sjellin dyshime mbi mundësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të vijimësisë.

#### (b) Vlera e drejtë e instrumentëve financiare

Në rastet kur vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare, e regjistruar në pasqyrën e gjendjes financiare, nuk mund të përfitohet nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur disa teknika të ndryshme vlerësimi të cilat përfshijnë dhe përdorimin e modeleve matematikore. Të dhënat që përdoren në këto modele janë të dhënat që vëzhgohen në treg, dhe kur këto të dhëna nuk janë të disponueshme, nëpërmjet gjykimit përcaktohen vlerat e drejta. Për instrumentët financiarë që nuk tregtohen shpesh dhe kanë transparencë të kufizuar për çmimin, vlera e drejtë është më pak objektive dhe nëvojiten nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë së faktoreve të tregut, supozime çmimi dhe risqe të tjera që prekin instrumentin e caktuar. Vlerësimi i instrumentëve financiarë paraqitet në mënyrë të detajuar në Shënimin 7.

#### (c) Humbjet nga zhvlerësimet për huatë dhe paradhëniet

Banka rishikon dhe analizon huatë dhe paradhëniet individuale të rëndësishme në çdo datë të hartimit të pasqyrës së gjendjes financiare për të vlerësuar nëse humbjet nga zhvlerësimi duhet të regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave. Në mënyrë të veçantë, gjykimi nga drejtimi është i nevojshëm për vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhjes së ardhshme të parasë kur përcaktohen humbjet nga zhvlerësimi. Në përlogaritjen e fluksit të parasë, banka gjykon situatën financiare të huamarrësit dhe vlerën neto të realizueshme të kolateralit. Këto çmuarje bazohen në supozime lidhur me disa faktorë dhe rezultatët aktuale mund të ndryshojnë, duke sjelle ndryshime të ardhshme në zbritjet nga huatë. Huatë dhe paradhëniet e vlerësuara në mënyrë individuale dhe rezultuar të pazhvlerësueshme, si dhe të gjitha huatë dhe paradhëniet individuale jo të konsiderueshme vlerësohen kolektivisht, në grupe aktivesh me karakteristika të ngjajshme rishikimit, për të përcaktuar nëse duhen krijuar provizionë për shkak të ngjarjeve të humbjeve për të cilat ekziston provë e dukshme, por efektët ende nuk janë të dukshme. Vlerësimi kolektiv merr në konsideratë të dhënat nga portofoli i huave (si cilësia e kredisë, niveli i vonësave, përdorimi i kredisë, etj) dhe përqëndrimet e tjera të riskut dhe të dhënave ekonomike.

Humbjet nga zhvlerësimi për huatë dhe paradhëniet paraqiten në mënyrë të detajuar në Shënimin 12.

#### (d) Të drejta tatimore të shtyra

Të drejtat tatimore të shtyra njihen në lidhje me humbjet nga tatimet deri në nivelin kur ekzistojnë gjasat që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm ndaj të cilit mund të përdoren humbjet. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e të drejtave të tatimit të shtyrë që do të njihet, në bazë të kohës dhe nivelit të ardhshëm të fitimit të tatueshëm dhe strategjive të ardhshme të planifikimit tatimor. Për më shumë detaje referojuni Shënimin 4 g.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë periudhën e pasqyrave financiare të konsoliduara si dhe janë aplikuar vazhdimisht nga njësitë e Bankës.

### (a) Monëdha e huaj

#### (i) Transaksionët në monëdha të huaja

Transaksionët në monëdhë të huaj janë konvertuar në monëdhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monëtare në valutë të huaj janë ri-konvertuar në monëdhën funksionale me kursët e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit. Të gjitha diferencat respektive si pasojë e kësaj të fundit, kalojnë në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që vijnë nga rivlerësimi i kapitalit të nënshkruar të paguar, të cilat transferohen menjëherë në një rezervë të posaçme të kapitalit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monëtare në valutë të huaj të matura me vlerën e drejtë, janë ri-konvertuar në monëdhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga ri-konvertimet njihen në llogarinë fitim humbje.

#### (ii) Opëracionët e huaja

Mjetët dhe detyrimet nga opëracionët e huaja janë konvertuar në monëdhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat e shpenzimet nga opëracionët e huaja janë konvertuar në monëdhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e konvertimit njihen direkt në kapital. Nga data 1 Janar 2007, data e kalimit të raportimit të Bankës sipas SNRF, këto diferenca janë pasqyruar në rezervën për diferencën valutore të rivlerësimit. Kur një opëracion i huaj mbyllet pjesërisht osë plotësisht, shumat përkatëse e diferencës valutore të rivlerësimit transferohet në llogarinë fitim humbje.

### (b) Intëresat

Të ardhurat dhe shpenzimet e intëresit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të intëresit. Norma efektive e intëresit është norma e cila bën zbritjen e pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë kohëzgjatjes së pritshme të aktivitet osë detyrimit financiar (osë mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitet osë detyrimit financiar. Norma efektive e intëresit përcaktohet me njohjen fillestare të aktivitet dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës efektive të intëresit përfshin të gjitha komisionët e paguara osë të arkëtuara, shpenzimet për transaksionët, dhe zbritjet osë primet që janë pjesë e normës efektive të intëresit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direktë blerjes, emetimit osë shitjes së një aktivi osë detyrimi financiar.

### (c) Komisionët

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionët që janë pjesë integrale e normës efektive të intëresit të një aktivi osë detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të intëresit.

Të ardhurat e tjera nga komisionët, përfshirë komisionët e shërbimit, komisionët për menaxhim investimi, komisionët për shitje dhe vendosje depozitë njihen në momentin e kryerjes së shërbimit.

Shpenzime të tjera nga komisionët lidhen kryesisht me komisionët për transaksionë dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (d) Të ardhura bankare nga tregtueshmëria, nëto

Këto të ardhura përfshijnë fitimin minus humbjet që rezultojnë nga tregtimi i aktiveve dhe detyrimeve, dhe përfshijnë të gjitha ndryshimet e vlerës së drejtë dhe diferencat e këmbimeve valutore.

### (e) Dividentët

Të ardhurat nga dividentët njihen kur vendosët e drejta për të përfituar të ardhura. Zakonisht, kjo bëhet në datën e ish-dividentit për letrat me vlerë të kapitalit. Dividentët pasqyrohen si komponënt i të ardhurave bankare nëto nga tregtueshmëria, të ardhurave nëto nga instrumentë të tjera financiare të matura me vlerën e drejtë osë të ardhurave të tjera operative, në bazë të klasifikimit të instrumentit të kapitalit.

### (f) Qeraja dhe përmirësimet e ambjentëve me qera

Përcaktimi nëse një marrëveshje është kontratë qiraje osë përmban një të tillë, bazohet në thelbin dhe përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim të faktit nëse përmbushja e detyrimeve të marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi osë aktiveve të veçantë dhe nëse në marrëveshje parashikohet e drejta për përdorimin e aktivitetit.

Banka ka vetëm marrëveshje qeraje operacionale, pagesat e të cilave njihen në pasqyrën e të ardhurave me metodën lineare gjatë gjithë kohëzgjatjes së qerasë. Shpenzimet për përmirësimin e ambjentëve që përdoren në bazë të këtyre marrëveshjeve kontabilizohen si mjetë të tjera dhe amortizohen linëarisht përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Pagesat rastësore për qeratë kontabilizohen me anë të rishikimit të pagesave minimale të qerasë për periudhën e mbetur në momentin e konfirmimit të ndryshimit të kontratës së qerasë.

### (g) Tatimi mbi fitimin

Të drejtat apo detyrimet aktuale tatimore për vitin aktual dhe ata të mëparshëm llogariten në atë vlerë që pritët për t'u mbuluar nga osë paguar të autoritetët tatimore. Normat e taksave dhe ligjet në lidhje me to të përdorura për llogaritjen e vlerës së detyrimit tatimor janë ato që ndodhen në fuqi apo që janë pothuajse fuqizuar në datën e bilancit.

Tatimi i shtyrë gjendet mbi diferencat e përkohshme në datën e bilancit ndërmjet bazës së taksueshme të mjetëve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre të mbartura për qëllime raportimesh financiare. Detyrime të shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme, përveç:

- ku detyrimi i shtyrë tatimor vjen si pasojë e njohjes fillestare të një të drejtë apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi, dhe në momentin e transaksionit, nuk ndikon as në fitimin kontabël as në fitimin apo humbjen e taksueshme; dhe
- në lidhje me diferencat e përkohshme të taksueshme të lidhura me investimet në filialet, ku koha e rikthimit të diferencave të përkohshme mund të kontrollohet dhe është e mundshme që diferencat e përkohshme të mos kthehen në një të ardhme të parashikueshme (të afërt).

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (g) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

E drejta tatimore e shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, deri në atë nivel ku është e mundshme që fitimi i tatueshëm të matërializohet kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme mund të përdoren, përveç:

- ku të drejtat tatimore të shtyra të lidhura me diferencat e përkohshme të zbritshme vijnë si pasojë e njohjes fillestare të një mjeti apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznësi, dhe që në momentin e transaksionit, nuk ndikon as në fitimin kontabël as në fitimin apo humbjen e tatueshme; dhe
- në lidhje me diferencat e përkohshme të zbritshme që i atribuohen investimeve në filiale, të drejtat e shtyra tatimore janë njohur deri në atë nivel ku është e mundshme që diferencat e përkohshme do të kthehen në një të ardhme të afërt dhe fitimi i tatueshëm do të jetë matërializuar kundrejt të cilit diferencat e përkohshme mund të përdoren.

Vlera e mbartur e të drejtave tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë bilanci dhe reduktohet deri në atë nivel që nuk është më e mundshme që një fitim i mjaftueshëm dhe i tatueshëm do të matërializohet për të lejuar që e gjitha apo një pjesë e të drejtave tatimore të shtyra të përdoren. Të drejtat tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë bilanci dhe njihen deri në atë nivel që është e mundshme që fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të mundësojë që të drejtat tatimore të shtyra të rimerren.

Të drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore matën me normat e taksave që priten të zbatohen në vitin në të cilin një e drejtë krijohet apo një detyrim shlyhet, i bazuar në normat e taksave (dhe ligjet për to) të fuqizuara apo pothuajse të fuqizuara në datën e bilancit.

Tatimi aktual apo i shtyrë që lidhet me zëra të cilët njihen menjëherë në kapital njihen gjithashtu në një rezervë në kapital dhe jo në pasqyrën e të ardhurave.

Të drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen me njëra-tjetrën nëse një e drejtë e detyrueshme ligjore ekziston për të kompensuar një të drejtë tatimore aktuale kundrejt një detyrimi tatimor aktual dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtët subjektë të tatueshëm dhe autoritetë tatimor.

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare

#### (i) Njohja

Banka fillimisht një huatë dhe paradhëniet, depozitat dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në ditën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen osë shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale për instrumentin.

#### (ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabël 4 (i) (j) (k) dhe (l).

#### (iii) Mos-njohja

Banka nuk e njeh me një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, osë kur transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo intëres në aktivet financiare të transferuara që krijohet osë mbahet nga Banka njihet si një aktiv osë detyrim me vetë. Banka nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anulohen osë kur u skadon afati.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (h) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

#### (iii) Mos-njohja (vazhdim)

Banka kryen transaksionë nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në bilancin e saj kontabël, por mban të gjitha osë në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktiveve të transferuara, apo ndonjë pjesë të tyre. Në rast së Banka merr përsipër të gjitha osë në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale osë të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në bilancin kontabël. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që merren përsipër të gjitha osë në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale osë të mëvonshme përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionët e riblerjes.

Për transaksionët ku Banka nuk mban dhe as transferon në mënyrë thelbësore rreziqet dhe shpërblimet aktuale osë të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njëh aktivin në rast së nuk ka kontroll mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen me vetë si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në transferime, ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin për aq kohë sa ky aktiv rezulton i përfshirë, e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar .

Banka fshin kredi të caktuara të cilat përcaktohen si kredi të pakthyeshme (shih Shënimin 5). Rimarrja e një zëri të fshirë nga bilanci regjistrohet nën zerin Të ardhura/shpenzime të tjera në pasqyrën e të ardhurave (shih Shënimin 28).

#### (iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera nëto paraqitet në bilancin kontabël kur, dhe vetëm kur Banka gëzon tëë drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën nëto osë likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqitën nëto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit, osë për fitime apo humbje të cilat rezultojnë nga realizimi i transaksionëve të ngjashme si në aktivitetin tregtar të Bankës.

#### (v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e aktivitet osë detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivi dhe detyrimi financiar matët në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus osë minus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e intëresit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar, duke zbritur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

#### (vi) Matja me Vlerën e Drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar në treg osë çmimet e kuotuar nga agjenti për instrumentët financiare të cilat tregtohen në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiare vlera e drejtë përcaktohet me anë të tëknikave të vlerësimit. Tëknikat e vlerësimit përfshijnë tëknikat e vlerës aktuale nëto, metodën e zbritjes së fluksit të mjetëve monëtare, krahasimin me instrumentë të ngjashme për të cilat në treg ekzistojnë çmimet përkatëse, dhe modelet e vlerësimit. Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentëve financiare tëë zakonshme dhe të thjeshta si opsionët dhe kontratat "sëap" të normave të intëresit dhe këmbimeve valutore. Për këto instrumentë financiare informacionët që përdoren në modele janë të dukshme në treg.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

#### (vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Në çdo datë të bilancit kontabël, Banka vlerëson nëse ekzistojnë prova objektive që aktivet financiare të cilat nuk janë mbajtur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuara nëse vërtëtohet përmes provave objektive që humbja ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe së ngjarja që ka shkaktuar humbjen do të influencojë në fluksin e ardhshëm të mjetëve monetare të aktivitetit, që mund të vlerësohet besueshëm.

Banka merr në konsideratë treguesit për zhvlerësimin e aktiveve në nivelin e një aktiviteti të vetëm dhe kolektivisht. Të gjitha aktivet financiare të rëndësishme vlerësohen veçmas për zhvlerësime specifike. Të gjitha aktivet e rëndësishme të cilat nuk rezultojnë të zhvlerësuara në veçanti, vlerësohen të gjitha së bashku për ndonjë zhvlerësim që mund t'i ketë ndodhur, por që nuk është identifikuar ende. Aktivet që nuk janë të rëndësishme me vetvlerësohen së bashku për identifikimin e zhvlerësimit, duke grupuar së bashku aktivet financiare (të mbajtura me koston e amortizuar) të cilat paraqesin karakteristika të ngjashme të riskut.

Prova objektive që vërteton zhvlerësimin mund të jetë mospërbushja e detyrimeve dhe shkelja nga ana e klientit, ristrukturimi i kredisë ose parashënies nga banka me kushtë të cilat Banka nuk do t'i merrte në konsideratë në rast të kundërt, tregues që huamarrësi ose emetuesi do të shpallë falimentin, zhdukjen e një tregu aktiv për letrat me vlerë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që ekzistojnë lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime jo të favorshme në statusin e likuidimit të huasë së kredimarrësit ose emetuesit në grup, apo të kushtëve ekonomike që lidhen me mospërbushjen e detyrimeve në grup. Huatë dhe parashëniet që u jepen klientëve klasifikohen si nënstandart; të dyshimta; të humbura; të ristrukturuara sipas përcaktimeve të Bankës Qëndrore të Shqipërisë, dhe nëse u ka kaluar afati për më shumë se 30 ditë, ato bëhen subjekt i vlerësimit individual për identifikimin e zhvlerësimit specifik.

Banka vlerëson për identifikime të zhvlerësimeve individuale përkrah huave me probleme, ato hua të cilat në datën e vlerësimit janë me vonësë me më shumë se 30 ditë. Ky zhvlerësim matët si diferencë ndërmjet vlerës së mbartur të kredisë, dhe vlerës aktuale të fluksit të parashikuar të të ardhurave, duke marrë në konsideratë fluksët e të ardhurave nga mbulimet e pengjeve dhe/osë garancive të cilat sigurojnë këto ekspozime. Në rast se rezulton një humbje, vlera e mbartur e kredisë zvogëlohet nga provizioni për zhvlerësimin e mundshëm, i njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave.

Pas ushtrimit të mësipërm, zhvlerësimet varen nga faktorë të tjerë ose parametra vlerësimi të cilat përdoren për llogaritjen e vlerës aktuale të fluksëve të ardhshme të parasë, si p.sh.: vlera e realizueshme e pengjeve ose koha e përfuturit të fluksëve të pritshme të parasë.

Të gjithë klientët që kanë linja huajë të ristrukturuara janë subjekt i testimeve për zhvlerësim individual. Ato mbetën pjesë e këtyre vlerësimeve për një periudhë prej të paktën një viti nga data e ristrukturimit dhe/osë datës së riskedulimit, pavarësisht nga pagesat e kryera në vazhdimësi të kushtëve të reja të ripagimit.

Të gjitha huatë për të cilat "nuk identifikohen prova objektive zhvlerësimi" vlerësohen në mënyrë kolektive. Vlerësimi kolektiv bëhet sipas grupeve të kredive me karakteristika të ngjashme risku, dhe duke marrë në konsideratë historikun e normave të dështimit dhe përqindjeve përkatëse për humbjet nga kreditë, në bazë të elementëve të dukshëm në datën e bilancit. Vlerësimi merr parasysh, gjithashtu, edhe riskun që paraqet vendi i huamarrësit.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (h) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

#### (vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve matën në bazë të diferencës së shumës së mbartur të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të përlogaritur të mjetëve monëtare të skontuar me normën fillestare efektive të intëresit të aktiveve. Humbjet njihen tëk pasqyra e të ardhurave dhe paraqitën në llogarinë e zbritjes së huave dhe paradhënies.

Kur një ngjarje e mëvonshme influencon në zvogëlimin e shumës së humbjes nga zhvlerësimi i aktivitetit, humbja kthehet tëk pasqyra e të ardhurave.

Aty ku është e mundur Banka bën ristrukturimin/rinëgocimin e huave sësa marrjen në zotërim të kolateralit. Kjo përfshin zgjatjen e afatit të pagesave për kthimin e huasë dhe marrëveshje për kushtë të reja kredie. Menjëherë pas rinëgocimit të kushtëve zhvlerësimi matët në bazë të normës efektive të intëresit fillestar siç është llogaritur përpara ndryshimit dhe modifikimit të kushtëve dhe huaja nuk konsiderohet e maturuar. Drejtimi në mënyrë të vazhdueshme rishikon kreditë e rinëgociuara për të garantuar përmbushjen e të gjitha kritereve dhe kryerjen e pagesave në të ardhmen. Huatë vazhdojnë të mbetën subjekt i vlerësimit të zhvlerësimit individual osë kolektiv, e cila përlogaritet në bazë të normës efektive të intëresit fillestar.

#### (i) Mjetë monëtare dhe të ngjashme

Mjetë monëtare dhe të ngjashme përfshijnë mjetët në arkë, gjendjet e pakufizuara me bankat qëndrore dhe depozitat afatshkurtra shumë likuide me maturitet më pak së 3 muaj, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetë monëtare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

#### (j) Aktive dhe detyrime të tregtueshme

Aktive dhe detyrime të tregtueshme konsiderohen ato aktive dhe detyrime që Banka blen osë merr kryesisht për qëllimin e shitjes osë riblerjes brenda një afati të shkurtër, osë mban si pjesë të një portofoli që administrohet për realizimin e fitimit dhe marrjen e pozicionit brenda një afati të shkurtër.

Aktivitetet dhe detyrimet të tregtueshme njihen fillimisht dhe më pas matën me vlerën e drejtë në bilanc me shpenzimet për transaksionë të cilat pasqyrohen direkt tëk pasqyra e të ardhurave. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në pasqyrën e të ardhurave si pjesë e të ardhurave nëto nga tregtueshmëria. Aktivitetet dhe detyrimet e tregtueshme nuk rriklasifikohen pas njohjes fillestare të tyre.

#### (k) Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët

Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivativë me pagesa fikse osë të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme osë në një kohë të afërt. Huatë dhe paradhëniet matën në fillim me koston e amortizimit plus kostot e tjera të transaksionëve direktë, duke përdorur metodën e intëresit efektiv. Pas matjes fillestare, ato matën me koston e amortizimit me normën efektive të intëresit, duke zbritur vlerën e zhvlerësimit. Amortizimi përfshihet në të ardhurat nga intëresi në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave tëk humbjet nëto nga zhvlerësimi i mjetëve financiare. Nuk ekzistojnë zhvlerësime të cilat njihen për huatë dhe paradhëniet Bankave sikundër përcaktohet në mënyrë të detajuar tëk risku i kredisë në Shënimin 5.



## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (I) Investime në Letra me Vlerë

Letrat me vlerë kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, si letra me vlerë të investimit, letra me vlerë të tregtueshme osë letra me vlerë të vendosjes.

#### (i) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit janë aktive financiare jo derivative me të ardhura fiksë osë të përcaktueshme dhe me maturitetë fiksë që Banka ka qëllimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të tregtueshme osë letra me vlerë të vendosjes.

Letrat me vlerë të investimit matën me koston e amortizuar nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Të gjitha shitjet dhe riklasifikimet e një shume të konsiderueshme të letrave me vlerë të investimit që nuk janë afër maturimit riklasifikohen si investime në letra me vlerë të vendosjes dhe nuk e lejojnë Bankën t'i klasifikojë ato në investime në letra me vlerë të investimit për vitin ushtrimor aktual dhe dy vitët ushtrimore të ardhshëm.

#### (ii) Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo derivative të cilat nuk përbëjnë një kategori tjetër të aktiveve financiare. Të ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në pasqyrën e të ardhurave kur Banka gëzon të drejtën mbi dividendin. Fitimet osë humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen direkt në kapital deri sa investimi të shitët osë zhvlerësohet, dhe gjendja në kapital njihet më pas në pasqyrën e të ardhurave.

### (m) Ndërtësat dhe pajisjet

#### (i) Njohja dhe matja

Ndërtësat dhe pajisjet paraqitën me koston e tyre nëto pasi u është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së mjetit. Nëse pjesë të një mjeti kanë jetë përdorimi të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si elementë të veçanta (përbërësit kryesore) të ndërtësave dhe pajisjeve.

#### (ii) Kosto të tjera rrjedhëse

Kostot e zëvendësimit të një pjesë të një ndërtëse osë pajisjeje njihen me vlerën e mbartur të aktivitetit nëse është e mundur që të sigurohen përfitime të ardhshme ekonomike dhe nëse kostot e tij mund të matën në mënyrë të besueshme.

(iii) Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së jetës së dobishme të çdo pjesë të ndërtësës dhe pajisjes. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvlerësohen.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (m) Ndërtësat dhe pajisjet (vazhdim)

Ndryshimet në jetëgjatësinë e pritshme të përdorimit kontabilizohen duke ngarkuar periudhën osë metodën e zhvlerësimit në varësi të rastit, dhe trajtohen si ndryshime në përlllogaritjet (parashikimet) kontabël.

Jetëgjatësitë e parashikuara të përdorimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuesë janë të paraqitura si më poshtë:

<b>Ndërtësat</b>	<b>20 vjet</b>
<b>Mobiljet, orenditë dhe pajisjet</b>	<b>5 vjet</b>
<b>Kompjuterat dhe pajisje të tjera kompjuterike</b>	<b>4 vjet</b>

### (iv) Mos-njohja

Ndërtësat dhe pajisjet nuk njihen më në momentin kur hiqen të drejtat dhe kontrolli mbi to dhe kur nga përdorimi i tyre asnjë përfitim ekonomik në të ardhmen nuk pritët të realizohet. Çdo humbje apo fitim nga mosnjohja e një aktivi (të llogaritur si diferencë ndërmjet të ardhurave nga vlera e shitjes dhe vlerës së tij të mbartur) njihet në kategorinë "Të ardhura të tjera operacionale" në pasqyrën e të ardhurave në vitin në të cilin ndodh mosnjohja.

### (n) Aktive Afatgjata Jomatëriale

Programet kompjuterike, liçensat dhe markat tregtare përbëjnë aktivet afatgjata jomatëriale. Programet e blera nga Banka paraqitën me koston nëto nga amortizimi i akumuluar. Shpenzimet e mëtejshme në aktivet afatgjata jomatëriale kapitalizohen vetëm nëse këto shpenzime rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjetei specifik. Çdo lloj kostoje tjetër shpenzohet në periudhën në të cilën kryhet.

Amortizimi pasqyrohet të pasqyra e të ardhurave duke përdorur metodën linëare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata jomatëriale. Mjetët e qëndrueshme të patrupëzuara amortizohen nga data e fillimit të përdorimit të tyre. Jetëgjatësia e parashikuar për periudhën aktuale dhe krahasuesë vijon si më poshtë:

<b>Programet kompjuterike</b>	<b>4 vjet</b>
<b>Liçensat dhe markat tregtare</b>	<b>10 vjet</b>

### (o) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo financiare të Bankës, të ndryshme nga aktivet tatimore të shtyra, rishikohet çdo datë raportimi, për të përcaktuar nëse ka tregues të zhvlerësimit. Në rast së rezultojnë tregues të tillë, atëherë përlllogaritët vlera e rikupërueshme e aktivit.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen nëse shuma e mbartur e një aktivi osë njësie që gjenëron të ardhura e tëjkalon shumën e vlerës së rikupërimit. Njësia që gjenëron të ardhura është grupi më i vogël i aktivitetit, i identifikueshëm që gjenëron fluksë të mjetëve monëtare të cilat janë shumë të pavaruara nga aktivet e tjera dhe grupet. Humbjet nga zhvlerësimi njihen tëk fitimi osë humbjet. Humbjet nga zhvlerësimi lidhur me njësitë e gjenërimit të të ardhurave shpërndahen për të reduktuar shumën e mbartur të aktiveve të tjera në njësi (grup njësis) në mënyrë proporcionale.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (o) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare (vazhdim)

Vlera e rikupërueshme e një aktivi osë njësie gjenërimi të të ardhurave është më e madhja prej vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot për t'u shitur. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksi i të ardhurave të parashikuara skontohej në vlerë aktuale me normën e zbritjes para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut me vlerën kohë të pasasë dhe risqet specifike të aktivitetit.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura gjatë periudhave të mëparshme vlerësohen në datën e raportimit për të verifikuar nëse ka tregues që pasqyrohen së humbjet janë zvogëluar osë nuk janë me ekzistëntë. Humbjet nga zhvlerësimi kthehen në rast se ka pasur ndonjë ndryshim në përlogaritjet e bëra për përcaktimin e shumës së rikupërueshme. Humbjet nga zhvlerësimi kthehen vetëm kur shuma e mbartur e aktivitetit nuk e tejkalon shumën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pa zhvlerësimin dhe amortizimin, nëse nuk do të njëhej asnjë humbje nga zhvlerësimi.

### (p) Depozitat dhe borxhet e varura

Depozitat dhe borxhet e varura përbëjnë burimet e financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivitetit (osë të një aktivi të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të më vonë ("repo" osë "stock lending") marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht matën me vlerën e drejtë plus kostot direktë të transaksionit, dhe më pas matën me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, përveçse kur Banka vendos të mbartë detyrime me vlerën e drejtë nëpërmjet njohjes së fitim – humbjeve.

### (q) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve) dhe letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për të riblerë (marrëveshjet për riblerje), trajtohen si transaksionë financiare me kolateral në formën e parapagimeve osë arkëtimeve plus interesin e përlogaritur.

Letrat me vlerë të marra mbi bazën e marrëveshjeve të riblerjes së anasjelltë dhe letrat me vlerë të dhena sipas marrëveshjeve të riblerjes nuk njihen osë hiqen nga bilanci, derisa hiqet dorë nga kontrolli i të drejtave kontraktuale të cilat përfshijnë këto letra me vlerë.

Intëresat e fituara nga marrëveshjet e riblerjeve të anasjellta dhe interesi i marrëveshjeve të riblerjeve njihen si të ardhura nga interesi osë shpenzime interesi për sëcilën marrëveshje, mbi jetën e çdo marrëveshje. Të gjitha marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta janë bere me Banken Qendrore të Shqipërisë.

### Sigurimi me kolateral mjete monëtare i marrëveshjeve të riblerjes së anasjelltë/marrëveshjet e riblerjes.

Transaksionët e huadhënies dhe huamarrjes së letrave me vlerë në përgjithësi janë të siguruar me letra me vlere osë mjete monëtare. Transferimi i letrave me vlerë kundrejt palëve pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse transferohen edhe risqet dhe shpërblimet e pronësisë. PAGESA osë arketimi paraprak si kolateral regjistrohet si aktiv osë pasiv. Informacion më i detajuar pasqyrohet në Shënimet 11 dhe 16.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (r) Provizionët

Një provizion mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën Banka disponon një detyrim ligjor osë konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkoje dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provizionët përcaktohen duke përdorur si normë skontimi për fluksët e pritshme të parasë në të ardhmen, një normë para taksore e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe specifikat e riskut për detyrimin.

### (s) Garancitë financiare

Garancitë financiare janë kontrata që kërkojnë që Banka të realizojë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka ndodhur si rezultat i mungesës së pagesës sipas termave kontraktore për një instrument borxhi nga një debitor i caktuar.

Detyrimet për garancitë financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë, e cila amortizohet gjatë jetës së garancisë financiare. Rrjedhimisht detyrimi i garancisë mbartet me vlerën më të lartë midis vlerës së amortizuar dhe vlerës aktuale të ndonjë pagesë të pritshme. (kur pagesa në lidhje me garancinë bëhet e mundshme).

Garancitë financiare janë të përfshira tek detyrime të tjera.

### (t) Përfitimet e punonjësve

#### (i) Planët e përcaktuara të kontributeve

Banka operon vetëm me kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që sigurojnë përfitime pensioni për personëlin në momentin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjës për të siguruar minimumin e nivelit të pensionit sipas ligjit për pensionët në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar kontributi për pensionin. Kontributet e Bankës ndaj përfitimeve të planit të pensionit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

#### (ii) Përfitimet afatshkurtër

Detyrimet për përfitimet afatshkurtër të punonjësve llogariten mbi një bazë të paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur shërbimi përkatës është siguruar. Një provizion njihet për vlerën e pritshme për t'u paguar nëqoftëse Banka ka një detyrim aktual ligjor osë konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punonjësi dhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

### (u) Deklarata të reja (standarde të reja, ndryshimet/rishikimet e standardeve osë interpretimeve të tyre) në fuqi për vitin ushtrimor të mbyllur me 31 Dhjetor 2009.

#### i) Interpretimet dhe amendimet (ndryshimet) e standardeve të mëposhtme u bënë të detyrueshme për here të parë për vitin financiar të filluar më 1 Janar 2009:

Në Maj 2008, BSNK publikoi ndryshimet e SNRF "Përmirësimet e SNRF", të cilat rezultuan nga projekti i BSNK për përmirësimet vjetore. Ato përfshijnë amendimet dhe ndryshimet që rezultojnë në ndryshimet kontabël për qëllime prezantimi, njohje dhe matje si dhe ndryshimet e terminologjisë osë editoriale që lidhen me morinë e standardeve individuale të SNRF. Pjesa më e madhe e amendimeve janë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar në dhe pas datës 1 Janar 2009, duke lejuar aplikimin me të hershëm. Këto amendime nuk kishin asnjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar osë ecurinë dhe progresin e Bankës.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata të reja (vazhdim)

SNRF 2, "Pagesat të bazuara në aksionë"-Kushtet e Investimit dhe Anullimet (Amenduar), u publikua në Janar 2008 dhe hyri në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2009. Ky amendim sqaron përkufizimin e kushteve të investimit dhe përshkruan trajtimin kontabël të një shpërblimi që anulohet efektivisht për shkak të mos-plotësimit të një kushti jo-investimi. Ky amendim nuk kishte asnjë ndikim në situatën financiare osë ecurinë e Bankës.

SNRF 8, "Sëgmetet Operacionale", në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2009. Ky standard parashikon dhënien e informacionit për sëgmetet operacionale të subjektit dhe zëvendëson kërkesën për përcaktimin e sëgmeteve primare (biznësit) dhe sëkundare (gjeografik) të raportimit të subjektit. Miratimi i këtij standardi nuk kishtë asnjë impakt në situatën financiare osë ecurinë e Bankës. Banka përcaktoi së sëgmetet operacionale janë të njëjtë me sëgmetet e biznesit të identifikuar tek SNK 14 "Raportimi Sëgmental".

IFRIC 13, "Programet e besnikërisë së klientit", u publikua në Qershor 2007 dhe në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 Korrik 2008. Ky interpretim kërkon që shpërblimet për besnikërinë e klientëve të merren në konsideratë si një përbërës i veçantë i transaksionëve të shitjes në të cilat ato janë ofruar dhe atëherë një pjesë e vlerës së drejtë të këtyre shumave të marra, vendosët si pjesë e shpërblimit të dhënë dhe shtyhet në kohë derisa këto kreditë shpërblimi plotësohen. IFRIC 13 nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës pasi nuk ekzistojnë skema të tilla.

IFRIC 15, "Marrëveshje për Ndërtimin e Pasurive të Paluajtshme", u publikua në Korrik 2008 dhe në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2009 dhe duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive. Ky interpretim sqaron kur dhe si të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura nga shitja e një njësie të pasurisë së paluajtshme duhet të organizohet nëse një marrëveshje midis zhvilluesit dhe blerësit arrihet përpara përfundimit të ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. IFRIC 15 të drejton edhe lidhur me mënyrën së si të përcaktosh nëse një marrëveshje për ndërtimin e një pronë të paluajtshme është pjesë e qëllimit të SNK 11 'Kontrata Ndërtimi' osë SNK 18 'Të ardhurat' dhe, rrjedhimisht, kur duhet të njihen të ardhurat nga ky ndërtim. IFRIC 15 nuk ka lidhje me operacionët e Bankës pasi Banka nuk ofron shërbim të ndërtimit të pasurive të paluajtshme, apo të zhvillojë pasuri të paluajtshme për shitje, për rrjedhojë nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

IFRIC 16, "Mbrojtjet e Investimeve Nëto në një veprimtari të huaj", u publikua në Korrik 2008 dhe hyri në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në dhe pas datës 1 Tetor 2008. Ky interpretim ofron udhëzime për identifikimin e risqeve të këmbimit valutor të cilat kualifikohen për mbrojtjen kontabël të investimeve nëto, kur mund të mbahet brenda grupit instrumenti mbrojtës dhe si një subjekt duhet të përcaktoje shumën e fitimit osë humbjes nga këmbimet valutore, të cilat lidhen me investimin nëto dhe instrumentin mbrojtës, që do të riciklohet me shitjen e investimit nëto. Ky interpretim nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata të reja (vazhdim)

IFRIC 9 “Rivlerësimi i derivatëve të përfshira në instrumentët financiarë” (Amenduar). Amendimet janë në fuqi për periudha vjetore që përfundojnë në osë pas datës 30 Qershor 2009. Ato kërkojnë që subjektet të vlerësojnë nëse duhet të ndajnë një derivativ të përfshire në instrumentet financiare nga një kontratë pritëse nëse subjekti e klasifikon një aktiv financiar hibrid jashtë vlerës së drejtë përmes kategorisë së të ardhurave. Ky vlerësim behet në rrethana të cilat ekzistojnë jo me vonë së data kur subjekti është bere pale në kontratë dhe së data e amendimeve të kontratës të cilat ndryshojnë konsiderueshem rrjedhen e parasë së kontratës. Zbatimi i ketij amendimi nuk kishtë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankes pasi nuk u be asnjë riskklasifikim për instrumentët me përmbajtje derivativesh.

IFRIC 18, “Transferimet e Aktiveve nga Klientët”, u publikuan në Janar 2009 dhe hyri në fuqi në menyre prospektive për transferimin e aktiveve nga klientë të marra në osë pas datës 1 Korrik 2009, lejuar të aplikohet paraprakisht. Interpretimi është i zbatueshem nga subjektë që marrin kontributë në prona, pajisje dhe makinëri nga klientët e tyre. Ky interpretim udhëzon në lidhje me kontabilitetin e marrëveshjeve në baze të së ciles një subjekt merr nga klienti një pronë, pajisje apo makinëri që subjekti duhet ta përdore osë për të lidhur klientin me një rrjet të caktuar osë t’i siguroje klientit aksës të vazhdueshem për të ofruar mallrat dhe shërbimet , osë të dyja. IFRIC 18 nuk është i aplikueshem për pasqyrat financiare të Bankes, pasi Banka normalisht nuk ka si qellim të marre nga klientët kontributët e aktiveve, për rrjedhoje nuk kishtë asnjë ndikim në situatën financiare dhe ecurinë e Bankes.

### ii) Standardet e reja të mëposhtme, amendimet e standardëve dhe interpretimet janë publikuar por nuk janë efektive për vitin financiar të filluar me 1 Janar 2009:

“Përmirësime në SNRF”. Në Prill 2009 BSNK publikoi pjesën e dytë të amendimeve të vetë standardeve, kryesisht me qellim heqjen e mospërputhjeve dhe shpjegimin e formulimit të tyre. Pjesa me e madhe e amendimeve janë në fuqi për periudha vjetore që fillojnë me ose pas datës 1 Janar 2010. Ekzistojnë dispozita të përkohshme për çdo standard. Këto amendime nuk do të kenë asnjë ndikim në politikat kontabël, gjendjen financiare dhe ecurinë e Bankës, përveç amendimeve të mëposhtme që ndryshojnë politikat kontabël, si me poshtë:

- SNRF 5, “Aktive Afatgjata që mbahen për t’u shitur dhe Operacionet jo të vijueshme”: sqaron së dhënia e informacionit që kërkohet në lidhje me aktivet jo-afatshkurtra dhe grupe në mbyllje të cilët janë klasifikuar për shitje ose operacione jo të vijueshme janë vetëm ato të parashikuara në SNRF 5. Kërkesat për dhënie informacioni e SNRF të tjera aplikohet vetëm nëse kërkohet në mënyre të veçantë për aktivet jo afatshkurtra ose operacionet jo të vijueshme. Banka është duke vlerësuar nëse ky amendim do të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.
- SNRF 8, “Informacion për Segmentet Operacionale”: sqaron së aktivet dhe detyrimet duhet të raportohen vetëm kur këto aktive dhe detyrime përfshihen në masat që përdoren nga vendimmarrësi kryesor operacional. Duke qenë së vendimmarrësi kryesor operacional i Bankës rishikon aktive dhe detyrimet segmentare, Banka është duke vlerësuar ndonjë impakt të mundshëm të dhënies së informacionit.
- SNK 7 “Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë”: Në mënyre të qartë sqaron së vetëm shpenzimet që rezultojnë për njohjen e një aktivi mund të klasifikohen si rrjedhje e parasë nga aktivitetet e investimit.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata të reja (vazhdim)

- SNK 36 “Zhvlerësimi (dëmtimi) i Aktiveve”: Ky amendim sqaron së njëzia me e madhe e lejuar për ndarjen e emrit të mire, përfituar në një biznes të kombinuar, është segmenti operacional përcaktuar në SNRF 8 përpara bashkimit për qëllime raportimi. Është vlerësuar së amendimi nuk do të ketë asnjë ndikim në Banke.

SNK 39 “Instrumentet Financiare: njohja dhe matja” – Zërat e Pranueshme të mbrojtura (Amenduar). Ky amendim u publikua në Gusht 2008, dhe hyn në fuqi për periudha vjetore në ose pas datës 1 Korrik 2009. Amendimi trajton përcaktimin e riskut të njëanshëm të një zëri të mbrojtur, dhe përcaktimin e inflacionit si një risk të mbrojtur ose pjesë e situatave të caktuara. Ky standard sqaron së një subjekt lejohet të përcaktojë një pjesë të ndryshimeve të vlerës së drejtë ose ndryshueshmërisë së rrjedhës së parasë së një instrumenti financiare si zë i mbrojtur. Drejtimi nuk mendon së SNK 39 do të ndikojë në Pasqyrat financiare të Bankës, pasi Banka nuk ka nënshkruar ndonjë marrëveshje mbrojtjeje.

SNRF 3, “Kombinimet e Biznesit” (Rishikuar) dhe SNK 27, “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Ndara” (Amenduar), u publikuan në Janar 2008 dhe hynë në fuqi për vitet financiare që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2009 me aplikim në mënyre perspektive. SNRF 3 i rishikuar prezanton disa ndryshime në kontabilizimin për kombinime biznesi të cilat do të ndikojnë në balancën e emrit të mire të njohur, rezultatet e raportuara për përdhën kur behet një blerje, dhe rezultatet e raportuara në të ardhmen. SNK 27 i amenduar kërkon që një ndryshim në interesin e pronësisë së një filiali të kontabilizohet si një transaksion kapitali. Prandaj, një ndryshim i tillë nuk do të ketë asnjë ndikim në emrin e mire, dhe nuk do të sjellë fitim apo humbje të kontrollit të një filiali. Banka është duke marre në konsideratë këto ndryshime në lidhje me ndikimet në të ardhmen, megjithatë amendimi i SNRF 3 nuk aplikohet për operacionet e saj.

SNRF 2, “Pagesa të Bazuara në Aksione”: Transaksione të pagesave të Grupit në mjetë monetare të bazuara në aksione (Amenduar), u publikua në Qershor 2009 dhe hyri në fuqi për vitet financiare që fillojnë në osë pas datës 1 Janar 2010. Amendimi, i cili zëvendëson IFRIC 8 dhe IFRIC 11, sqaron qëllimin dhe kontabilizimin e transaksioneve të pagesave të grupit në mjetë monetare të bazuara në aksione. Banka shpreson së ky amendim nuk do të ketë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të saj.

IFRIC 17, “Shpërndarja të Aksionëret e Aktiveve jo monëtare”, u publikua në 27 Nëntor 2008 dhe hyri në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në osë pas datës 1 Korrik 2009. IFRIC 17 zbatohet për shpërndarjet në mënyrë proporcionale të aktiveve jo në vlerë monëtare përveç për transaksionët e kontrollit të zakonshëm dhe kërkon që një dividend i pagueshëm duhet të njihet kur dividendi të jetë i autorizuar rregullisht dhe të mos jetë më në gjykimin e subjektit; një subjekt duhet të njohe diferencën midis dividendit të paguar dhe vlerës së mbartur të aktiveve nëto që janë shpërndare në pasqyrën e të ardhurave. Interpretimi kërkon gjithashtu së një subjekt duhet të sigurojë informacionë shtesë nëse aktive nëto të cilat mbahen për t’u shpërndare aksionëreve, plotësojnë kushtin e një operacioni jo të vijueshem. Banka shpreson së ky interpretim nuk do të ketë impakt në pasyrat e saj financiare. Megjithatë, duke qenë së interpretimi lidhet me dividendët e ardhshëm të cilat do të jenë subjekt i gjykimit të keshillit drejtues/aksionëreve nuk është i mundur përcaktimi paraprak i efektëve të zbatimit.

## 4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

### (u) Deklarata të reja (vazhdim)

SNK 32 "Paraqitja e Instrumenteve Financiare": Klasifikimi i të drejtave " (Amenduar). Në Tetor 2009, BSNK publikoi amendimin e SNK 32. Subjektet duhet të zbatojnë këtë amendim për periudha vjetore që fillojnë në ose pas 1 Shkurt 2010. Aplikimi paraprak është lejuar. Ky amendim ndryshon përkufizimin e një detyrimi financiar në SNK 32 për klasifikimin e të drejtave dhe opsioneve të caktuara ose garancive si instrumenta të kapitalit. Kjo është e zbatueshme nëse të drejtat i jepen në mënyrë proporcionale të gjithë aksionareve ekzistues të të njëjtës kategori të instrumenteve jo-derivative të kapitalit të një subjekti, për të blerë një numër të caktuar të instrumenteve të kapitalit të një subjekti për një shumë të caktuar në çdo monedhe. Banka beson se ky amendim nuk do të ketë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të saj.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare". Në Nëntor 2009 BSNK publikoi fazën e parë të SNRF 9 Instrumentet Financiare. Ky standard do të zëvendësojë SNK 39 Instrumentët Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 hyn në fuqi për vitët financiare që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2013. Subjektet mund të miratojnë fazën e parë për periudhat e raportimit që përfundojnë në ose pas datës 31 Dhjetor 2009. Faza e parë e SNRF 9 prezanton kriteret e reja për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Në veçanti, për matjen në vazhdim të gjithë aktivet financiare duhet të klasifikohen me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave me opsionin e parevokueshem që instrumentët e kapitalit të cilat nuk mbahen për t'u tregtuar të matën me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirësë. Në konsideratë të datës së fillimit të aplikimit, Banka është duke vlerësuar ndikimin që do të ketë miratimi i standardit të ri.

SNK 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale" (Amenduar), në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2009. Ky standard kërkon që kontabilizimi i ndryshimeve të interesave të pronësisë së një filiali i cili ndodh duke mos humbur kontrollin, të njihet si transaksion kapitali. Kur Banka humb kontrollin e një filiali, interesi i mbetur për ish filialin e saj do të matët me vlerën e drejtë ku fitimi dhe humbja do të njihen në pasqyrën e të ardhurave. Amendimet e SNK 27, të cilat bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës për vitin 2010, nuk priten të kenë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare.

SNK 24, "Dhënia e Informacioneve për Palët e Lidhura" (Rishikuar), u publikua në Nëntor 2009 dhe hyri në fuqi për periudha vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2011, aplikimi paraprak i të cilit lejohet. Rishikimi i standardit thjeshton kërkesat për dhënien e informacionit për subjektet e lidhura qeveritare dhe sqaron përcaktimin e një pale të lidhur. Me parë, një subjekt i kontrolluar ose me ndikim të madh të qeverisë duhet të jepte informacion për të gjitha transaksionet me subjektet e kontrolluara ose me ndikim të madh nga e njëjta qeveri. Standardi i rishikuar kërkon dhënien e informacionit për këto transaksione vetëm nëse kanë rëndësi individuale ose kolektive. Banka është duke shqyrtuar mundësinë e adoptimit të SNK 24 të rishikuar duke filluar nga data 1 Janar 2010.



## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Si pasoje e përdorimit të instrumenteve financiare, Banka ekspozohet ndaj risqeve të mëposhtëm:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operacional

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej llojeve të risqeve, objektivat e bankës, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

### Kuadri i Menaxhimit të Riskut

Bordi i Drejtoreve të Bankës ka përgjegjësi të plotë për vendosjen dhe mbikëqyrjen e strukturës së menaxhimit të riskut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aseteve dhe Detyrimeve dhe një Komitet Risku Kredie Lokal dhe Komiteti për Cilësinë e Aktiveve, të cilët janë përgjegjës për marrjen e vendimeve në fushat e tyre specifike, e mbështetën nga Departamenti i Thesarit dhe Divizioni i Menaxhimit të Riskut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të riskut të Bankës në këto fusha. Të gjitha komitetet e Bordit kanë anëtare ekzekutive dhe joekzekutive dhe raportojnë rregullisht tek Këshilli Drejtues lidhur me aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar riskun me të cilin përballet Banka, për të vendosur limitët dhe kontrollin e duhur si dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limitëve. Politikat e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtët e tregut si dhe produktet dhe shërbimet e ofruara. Aktualisht Banka po ndërton një kuadër të avancuar për drejtimin e risqeve financiare, nëpërmjet: implementimit të një programi kompjuterik për Menaxhimin e Aktiveve dhe Detyrimeve dhe prezantimit të metodologjive e standardëve drejtuese të reja lidhur me të. Banka nëpërmjet trajnimit, standardëve dhe procedurave të menaxhimit synon të zhvillojë një hapësirë kontrolli konstruktive dhe të disiplinuar, në të cilën të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

### Risku i Kredisë

Në aktivitetin normal bankar, Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë në huadhëniet dhe parapagesat ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zëra të tjerë jashtë bilancit.

Risku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose pale e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në realizimin e detyrimeve kontraktore që burojnë nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, institucioneve financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit. Për arsye raportimi të menaxhimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të kredisë ndaj riskut (risku individual i mospërbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal). Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë periodikisht duke monitoruar nga afër limitët e kredisë, portofolin e huave dhe përqendrimin e ekspozimit.

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR ( VAZHDIM)

### Menaxhimi i Riskut të Kredisë

Këshilli Drejtues i Bankës i ka deleguar përgjegjësi për marrjen e vendimeve Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, i cili ka krijuar Komitetin Lokal të Kredisë dhe i ka deleguar kompetenca për riskun e kredisë. Divizioni për Administrimin e Riskut, i cili raporton tek DPE, është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe administrimin e riskut të kredisë së Bankës, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- Formulon politika kredie duke: u konsultuar me njësitë e biznesit, mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësuar kredinë, nivelin e riskut dhe raportimin, procedurat e dokumentacionit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore.
- Vendos strukturën e autorizimit për aprovimin dhe rinovimin e lehtësirave të kredisë. Limitët e autorizimit shpërndahen në zyrat e kredisë të njësive të biznesit. Lehtësi me të mëdha kërkojnë aprovim nga Drejtori i Menaxhimit të Riskut të Kredisë, Komitetit Lokal të Kredive ose Bordit të Drejtoreshave sipas rastit.
- Rishikon dhe vlerëson riskun e kredisë. Departamenti i Kredisë vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë që e kanë tejkaluar limitin e caktuar, përpara së lehtësirave për kreditim të jepen ndaj klientëve nga njësia e biznesit e autorizuar për këtë gjë. Rishikimet dhe kontrolli i kushteve të kredisë janë objekt i të njëjtit proces kontrolli.
- Kufizon përqendrimin e ekspozimit ndaj palëve të biznesit, gjeografikisht dhe për nga industria, (për huadhënie dhe parapagesa) si dhe sipas lëshuesit, likuiditetit të tregut dhe vendit (për letrat me vlerë).
- Zhvillon dhe mirëmban klasifikimin e riskut të Bankës në mënyre që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballet si dhe të fokusojë menaxhimin e risqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë. Struktura e klasifikimit të riskut aktual, pranuar sipas rregulloreve të Bankës së Shqipërisë konsiston në pesë nivele, duke reflektuar nivele të ndryshme të riskut të mos shlyerjes së detyrimeve si dhe disponueshmërinë e kolateralit ose minimizimit të risqeve të tjera të huadhënies. Përgjegjësia për të vendosur nivelet e riskut bie mbi aprovimin final të Komitetit Lokal të Kredisë. Nivelet e riskut janë objekt i rishikimit mujor nga Menaxhimi i Riskut të Kredisë.
- Rishikon përputhshmërinë e njësive të biznesit me limitët e ekspozimit të miratuara duke përfshirë ato për industrinë e zgjedhura dhe llojet e produkteve. Komitetit Lokal të Kredive i sigurohen raporte mujore mbi cilësinë e kredive të portofoleve lokale ku gjithashtu paraqitet dhe tendenca e tyre dhe veprimet rregulluese të duhura që duhen ndërmarre.
- Ofron konsultën, drejtimin dhe aftësitë profesionale ndaj njësive të biznesit për të promovuar në Banke praktiken me të mire të menaxhimit të riskut të kredisë.

Çdo njësie biznesi i kërkohet të zbatojë politika dhe procedura kredie me autoritetet aprovuese të kredisë të deleguara nga Komiteti Lokal i Kredisë. Zyrtari përgjegjës për çdo njësie biznesi raporton si duhet për të gjitha çështjet lidhur me kreditë tek menaxhimi lokal, Risku i Kredisë ose Komiteti Lokal i Kredisë. Çdo njësie biznesi dhe Komiteti i Riskut të Kredisë janë përgjegjës për cilësinë dhe efektshmërinë e portofoleve të kredisë si dhe për monitorimin dhe kontrollin për të gjitha risqet e kredisë të tërë duke përfshirë dhe ato objekt të aprovimit nga qendra.

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredisë (vazhdim)

Ekspozimi Maksimal ndaj Riskut të Kredisë pa marre në konsideratë kolaterale apo ndonjë lehtësi tjetër kreditore (bruto nga ndonjë zhvlerësim)

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin aktual maksimal ndaj riskut të kredisë për komponentët e aplikueshem të bilancit:

	EKSPOZIMI MAKSIMAL BRUTO	
	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
Llogaritë me Banken Qendrore (duke përfshirë Arken)	3,902,454	2,864,865
Hua dhe paradhenie bankave	8,686,240	8,215,701
Hua dhe paradhenie klientëve	49,685,769	44,645,468
Aktive financiare-letra me vlere të vendosjes	2,643,232	1,963,807
Aktive financiare-letra me vlere të investimit	47,016,899	46,065,994
<b>Totali</b>	<b>111,934,594</b>	<b>103,755,835</b>
Huadhenie të aprovuara por jo të disbursuara	4,057,899	4,091,582
Letër Kredi	1,771,817	5,860,405
Garanci të dhena në favor të klientëve	4,998,971	6,500,946
<b>Totali i angazhimeve në lidhje me kredinë</b>	<b>10,828,687</b>	<b>16,452,933</b>
<b>Totali i Ekspozimit ndaj Riskut të Kredisë</b>	<b>122,763,281</b>	<b>120,208,768</b>

Ekspozimi maksimal i kredisë kundrejt një klienti apo grupi klientësh në 31 Dhjetor 2009 është 1,655,520 mije Lek (2008: 1,371,372 mije Lek) përpara marrjes në konsideratë të kolateraleve apo ndonjë lehtësie tjetër të kredisë.

Aty ku mjetet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e pasqyruara tregojnë ekspozimin e riskut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal të riskut i cili mund të rezultojë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve të vlerës.

Banka i mundëson klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të kryejë pagesa në përfitim të tyre dhe ndërmerr angazhime për të shtrire me tej linjat e kredisë për të siguruar nevojat e tyre të likuiditetit. Letër kreditë dhe garancitë e angazhojnë Bankën në kryerjen e pagesave në përfitim të klientëve në rast të një akti specifik, përgjithësisht i lidhur me importin dhe eksportin e mallrave. Të tilla angazhime e ekspozojnë Bankën në risqe kredie të ngjashme, të cilat zbutën nga të njëjtat procedura dhe politika kontrolli.

Çdo tremujor Banka vlerëson angazhimet e saj financiare për ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime të mundshme të këtyre angazhimeve janë huatë e klientëve me probleme ose huatë e atyre klientëve që janë ristrukturuar dhe/ose riskedular. Përfshirë bënë angazhimet financiare të cilat sigurohen me kolaterale të tilla si para në dore dhe/ose kundra garanci të vendosura nga kompania mëmë. Matja e humbjeve nga zhvlerësimet behet nëpërmjet të njëjtës metode, si për huatë dhe paradhëniet për klientët (referoju Shënimit 4 h vii).

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

### Risku i Kredisë (vazhdim)

#### Cilësia e Kredisë sipas klasave të aktiveve financiare

Tabelat me poshtë tregojnë cilësinë e kredisë për aktivet financiare të ekspozuara kundrejt riskut të kredisë, bazuar në klasifikimet e brendshme të Bankës. Huatë e vonuara por që nuk janë zhvlerësuar testohen në mënyre individuale dhe kolaterali i tyre apo rritja e kredive rrisin riskun ndaj të cilit ekspozohet Banka. Rritja e kredisë ka një përqindje të lartë rikuperimi, vlere të madhe dhe periudhe të shkurtër rikuperimi, të cilat influencojnë direkt në moskrijimin e zbritjeve për zhvlerësim për këtë grup kredish. Aktivet financiare në tabelën e mëposhtme paraqiten bruto pa zbritjet për zhvlerësimet për të dy vitët financiare me 31 Dhjetor 2009

31 Dhjetor 2009	As me vonesë as të zhvlerësuar	Me vonesë por jo të zhvlerësuar	Individualisht të zhvlerësuar	Totali
Llogari me Bankën Qendrore (duke përfshirë Arkën)	-	-	-	3,902,454
Hua dhe paradhënie bankave	-	-	-	8,686,240
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	28,875,305	5,961,904	6,023,570	40,860,779
Hua hipotekore	4,827,897	1,771,441	1,347,912	7,947,250
Hua konsumatore	722,341	20,883	181,290	924,514
Komision disbursimi, i shtyre	(32,123)	(7,469)	(7,182)	(46,774)
Aktive financiare-letra me vlere të vendosjes:				
Kompani të Listuara	-	-	-	1,963,139
Kompani jo të Listuara	-	-	-	680,093
Aktive financiare-letra me vlere të investimit:				
Kompani të Listuara	-	-	-	8,731,411
Kompani jo të Listuara	-	-	-	38,285,488
<b>Totali</b>	<b>34,393,420</b>	<b>7,746,759</b>	<b>7,545,590</b>	<b>111,934,594</b>

31 Dhjetor 2008	As me vonesë as të zhvlerësuar	Me vonesë por jo të zhvlerësuar	Individualisht të zhvlerësuar	Totali
Llogari me Bankën Qendrore (duke përfshirë Arkën)	-	-	-	2,864,865
Hua dhe paradhënie bankave	-	-	-	8,215,701
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	30,763,219	2,332,001	3,827,374	36,922,594
Hua hipotekore	5,844,272	866,421	740,518	7,451,211
Hua konsumatore	239,512	-	72,942	312,454
Komision disbursimi, i shtyre	(33,635)	(2,920)	(4,236)	(40,791)
Aktive financiare-letra me vlere të vendosjes:				
Kompani të Listuara	-	-	-	1,424,197
Kompani jo të Listuara	-	-	-	539,610
Aktive financiare-letra me vlere të investimit:				
Kompani të Listuara	-	-	-	8,713,417
Kompani jo të Listuara	-	-	-	37,352,577
<b>Totali</b>	<b>36,813,368</b>	<b>3,195,502</b>	<b>4,636,598</b>	<b>103,755,835</b>

Në huatë me vonesë më sipër janë përfshirë kreditë që janë më shumë se 30 ditë me vonesë.

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

### Risku i Kredisë (vazhdim)

Hua dhe paradhënie klientëve janë klasa e vetme e aktiveve financiare të rezultuara me vonësë e jo të zhvleresuara. Analiza e tyre respektive, sipas kohe vonësës me 31 Dhjetor 2009 dhe 2008 paraqitët si me poshtë:

31 Dhjetor 2009	31 në 90 ditë	91 në 180 ditë	më shume së 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	3,042,579	823,583	2,095,742	5,961,904
Hua hipotekore	647,894	374,105	749,442	1,771,441
Hua konsumatore	6,590	1,568	12,725	20,883
Komision disbursimi, i shtyrë	(3,475)	(1,198)	(2,796)	(7,469)
Totali	3,693,588	1,198,058	2,855,113	7,746,759

31 Dhjetor 2009	31 në 90 ditë	91 në 180 ditë	më shume së 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	409,845	952,429	969,727	2,332,001
Hua hipotekore	553,467	144,276	168,678	866,421
Hua konsumatore	-	-	-	-
Komision disbursimi, i shtyrë	(880)	(1,001)	(1,039)	(2,920)
Totali	962,432	1,095,704	1,137,366	3,195,502

Vlera e mbartur sipas klasave të aktiveve financiare për të cilat kushtët janë rinegociuar.

Tabela me poshtë tregon vlerën e mbartur të huave dhe paradhënieve për klientët, të cilat janë rinegociuar/riskeduluar, sipas produkteve:

	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
Hua tregtare	942,810	825,874
Hua hipotekore	52,919	35,340
Hua konsumatore	1,288	-
Totali	997,017	861,214

Huatë e rinegociuara , lidhur me analizën e mësipërme në kohe vonesë, klasifikohen në kategorinë e huave me me shume së 180 ditë vonësë.

## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

### Risku i Kredisë (vazhdim)

#### Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara janë ato për të cilat Banka mendon se është e mundur të ndodhe që të jetë e paaftë të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshem sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes së huasë. Banka i klasifikon huadhëniet dhe parapagimet ndaj klientëve në grupet: Standartë, Në ndjekje, Nën standartë, Të dyshimta dhe Të humbura në përputhje me rregulloret e Bankës së Shqipërisë për riskun e kredisë, ndërkohe që kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huadhëniet që shfaqin prova objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar të skontuar rrjedhën e ardhshme të parasë dhe duke e krahasuar me shumën e mbetur për huatë respektive. Huatë, provat objektive të të cilave nuk përmbushin kushtet për t'u testuar individualisht si të zhvlerësuara, testohen së bashku duke përdorur normat historike të Bankës për dështimin e kredive dhe kthimin osë zgjidhjen e zhvlerësimit për grupe kredish me karakteristika të ngjashme të riskut.

#### Zbritjet për zhvlerësim

Banka përcakton një për humbjet nga kreditë e zhvlerësuara që përfaqëson një përlogaritje për humbjet në portofolin e kredive. Komponentët kryesorë të kësaj zbritjeje janë një komponent i humbjes specifike që lidhet me ekspozimet e rëndësishme individuale, dhe një zbritje për humbjet në huatë e vlerësuara kolektivisht, të vendosura për grupe asetesh homogjenë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur por që nuk janë identifikuar në huatë objekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

Tabela me poshtë tregon Ekspozimin Neto të Huave dhe Paradhënies për klientët pas zbritjeve për zhvlerësim sipas kategorive të Bankës së Shqipërisë ku ky portofol klasifikohet respektivisht, duke qenë se kjo e fundit përben klasifikimin e brendshëm të huave dhe paradhënies klientëve përveç dy grupimeve të tjera kryesore; individualisht ose kolektivisht të zhvlerësuara, si me poshtë:

	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhënies klientëve	
	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
Individualisht të zhvlerësuara		
